



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 1 MARS 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 1. MARTA 2013. GODINE**

**MARS - MART
2013**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me demonstratën e 10 shkurtit 2007, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Dnevni red

1. Parlamentarna debata u vezi sa demonstracijom od 10. februara 2007., prema zahtevu Parlamentarne grupe Pokreta “Vetëvendosje”

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, një çështje urgjente e ka shtruar deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Meqë dje unë dhe kolegja ime nga radhët e LDK-së, Vjosa Osmani, e kemi shtruar një çështje për rastin e Gjykatës Kushtetuese për vendimin për Diana Kastratin, që të dyja nuk kemi arritur që ta përfundojmë fjalimin.

Unë kam obligim para qytetarëve dhe para juve si deputetë ta përfundoj këtë fjalim, sepse konsideroj se është rast me ndjeshmëri të lartë.

E mora fjalën lidhur me rastin e djeshëm, kur në këtë foltore e kam përmendur emrin e një gruaje, e cila për vite me radhë ka qenë pre e dhunës në familje. Unë këtu e kam edhe kërkesën drejtuar Gjykatës Komunale në Besianë për urdhër-mbrojtje, e cila për vite me radhë nuk ka marrë përgjigje, ndërsa këtë kërkesë ajo më pas e ka dorëzuar edhe në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut. Dhe, unë këtu e kam gjithë materialin dëshmues.

Do të thotë, pas fjalës së djeshme në këtë Kuvend dhe në këtë foltore ka reaguar edhe Prokuroria e Shtetit, duke e marrë këtë grua nën mbrojtje. Kjo duhet të jetë praktikë e përditshme e Prokurorisë që grave, të cilat janë pre e dhunës në familje t'u ofrojë mbrojtjen, të cilën ato e meritojnë.

Prokuroria nuk duhet të presë dhe të reagojë vetëm atëherë kur emrat dalin dhe thuhet këtu në Parlament, në këtë foltore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Veprimi ynë i menjëhershëm në këtë rast, edhe ky veprim i Prokurorisë mund ta parandalojë një krim të mundshëm, ndërsa heshtja do të na bëjë të gjithëve këtu pjesë të mekanizmit të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj gruas, në veçanti.

Si përfaqësues dhe mbrojtës të interesave të qytetarëve të Kosovës e kemi detyrim t'i mbrojmë ligjet dhe Kushtetutën, të cilën e kemi miratuar këtu vetë. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me demonstratën e 10 shkurtit 2007, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në bazë të nenit 15, pika 8 e Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me demonstratën e 10 shkurtit 2007.

E ftoj deputetin Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, në cilësinë e propozuesit të çështjes, që ta marrë fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuara familje të Arben Xheladinit dhe Mon Balajt, të rënë në demonstratën e 10 shkurtit të vitit 2007,

Të nderuar Zenel Zenel dhe Hysni Hyseni, të plagosur rëndë në demonstratën e 10 shkurtit të vitit 2007,

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në gjuhën shqipe, fjala drejtësi është e mbarsur me një përmbajtje më se të denjë për kuptimin e saj fisnik. Drejtësi është ajo që është e drejtë. Ajo e vendos atë që është e drejtë, duke e ndëshkuar dhe duke e zbrapsur atë që është e padrejtë. E drejta është e duhura dhe e domosdoshmja. E drejtë është ajo që është drejt, ajo që rri drejt. Padrejtësia është e lakueshme. Drejtësia është dinjitet, e dinjitet do të thotë të ecësh drejt.

Drejtësia, në këtë kuptim, e merr trajtën e drejtimit. Drejtësia të drejton tek e vërteta. Drejtësia është drejtimit vleror i shoqërisë. Drejtësia të tregon kah dhe të tregon si. Duke u ndëshkuar e keqja, tregohet drejtimi i së mirës. Ka lloj-lloj drejtimesh, por drejtimi i gabuar nuk është drejtimit, sepse nuk është i drejtë. Drejtësia është drejtimi në kahun e drejtë, pra në kahun e duhur.

Duke qenë rruga më e shkurtër e mundshme, ajo që është e drejtë, pra ajo që është drejt, drejtësia është e drejtpërdrejtë. Pra, drejtësia është shkencore. Në drejtësi nuk ka sinonime dhe metafora. Aty ka fakte, argumente dhe vendime.

Shtrohet pyetja, në ç’kuptim 10 shkurti ishte mishërim i drejtësisë? E drejtë, siç dihet, është vetëvendosja. Jo më kot, kjo e drejtë quhet e drejta e popujve për vetëvendosje. Populli më 10 shkurt po kërkonte vetëvendosje, po e kërkonte këtë të drejtë, ashtu që fati politik i vendit tonë të përcaktohej nëpërmjet një vendimi të qytetarëve, e jo në pazare me Serbinë.

Pra, para 6 vjetësh u mbajt demonstrata e 10 shkurtit të vitit 2007. Kjo ishte një demonstratë e thirrur dhe e organizuar nga Lëvizja “Vetëvendosje”, paqësore në motivin, qëllimin dhe organizimin e vet, por e kthyer qëllimisht në të dhunshme nga forcat policore rumune, ukrainase dhe polake të policisë së UNMIK-ut.

Demonstrata ishte shprehje e pakënaqësisë qytetare ndaj Planit të Ahtisarit, që e përmbante ndarjen etnike të Kosovës dhe tjetërsimin e trashëgimisë sonë kulturore. Demonstrata ishte planifikuar shumë qartë, madje u dha publikisht edhe rruga konkrete e

marshimit të protestuesve, e cila do të fillonte te selia e Lëvizjes “Vetëvendosje”, do të kalonte kah Qeveria dhe do të përfundonte përpara selisë qendrore të UNMIK-ut.

Në sheshin “Nëna Terezë”, pikërisht përballë Teatrit Kombëtar, forca të shumta të policisë së UNMIK-ut e kishin bllokuar rrugën e protestuesve, duke mos na lënë të ecim tutje sipas marshutës së planifikuar dhe të bërë publike më herët.

Sipas të gjitha konventave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, kjo ishte shkelje, meqenëse dukej fare qartë se policia nuk kishte dalë aty për ta krijuar një zonë të veçantë të sigurisë përreth objekteve. Ajo kishte dalë në mes të sheshit, e kishte bllokuar gjithë sheshin, ishte pozicionuar në mënyrë fare frontale dhe vetëm priste që demonstruesit ta bënin një hap përpara. Një indikator i qartë se policia e UNMIK-ut kishte bërë plan për përdorimin e dhunës atë ditë ishin edhe armët e shumta të grumbulluara në shesh.

Këto ishin kryesisht armë të gjata, të cilat shërbejnë për të shtëna me plumba gome, si dhe armët e hedhjes së gazit lotsjellës. Policia e Kosovës e përbënte rendin e parë të kordonit bllokues,

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: 10 minuta, regjia ia vazhdo fjalën.

GLAUK KONJUFCA: ...por demonstruesit nuk u ndalën seriozisht nga policia jonë. Kur protestuesit erdhën te rendi i kordonit në të cilin ishin të vendosura formacionet rumune, ukrainase dhe polake të UNMIK-ut, këto të fundit filluan shtënien me armë në drejtim të protestuesve duarthatë.

Shumë prej demonstruesve morën goditje në pjesët e epërme të trupit, kryesisht mbi bel, në gjoks dhe në kokë. Kurse sipas konventave për përdorimin e armëve me plumba gome specifikohet fare qartë se shënjestrimi i protestuesve bëhet në pjesët e poshtme të trupit, kryesisht në gjymtyrë, pra me qëllim të neutralizimit të lëvizjes.

Kjo tregon se atë ditë policia e UNMIK-ut nuk e kishte për qëllim neutralizimin e protestuesve, por dëmtimin maksimal të tyre. Pikërisht për këtë shkak dhe këtë mënyrë të përdorimit qëllimkeq të këtyre armëve, e humbën jetën Arben Xheladini dhe Mon Balaj, si dhe u plagosën mi 80 veta, prej të cilëve më së rëndi Zenel Zeneli, me plumbin ende afër zemrës, si dhe Hysni Hyseni, që e humbi syrin, e po ashtu edhe Mustafë Nerjovaj, që e humbi një pjesë të kafkës së tij.

Në vend që për këto krime të ndiqeshin kriminelët që i shkaktuan ato, UNMIK-u e burgosi Albin Kurtin për gati një vit, si dhe mbylli disa zyre të Lëvizjes “Vetëvendosje” nëpër Kosovë.

Kryepolici i UNMIK-ut, Stephen Curtis, u kthye në shtëpinë e vet, kurse Rumania e dekoroi policinë e saj për këtë vepër të kryer.

Në një hetim që u krye nga vetë UNMIK-u për këtë ngjarje kriminale, kryeprokurori Robert Dean e përpiloi një raport, në të cilin tha se përdorimi i forcës nga policia ka qenë i tepërt dhe i shmangshëm. I 'tepërt' dhe i 'shmangshëm' janë fjalë origjinale, të cilat po i citoj nga vetë raporti i kryeprokurorit, Robert Dean.

Dhe, se viktimat e 10 shkurtit janë pasojë e përdorimit të dhunës së shfrenuar nga policia e UNMIK-ut.

Më 10 shkurt u vranë dy qytetarë dhe u plagosën me dhjetëra, por deri tash askush nuk është dënuar për këtë krim. Një dëgjim i organizuar nga UNMIK-u përfundoi në mënyrë të turpshme, duke ua kërkuar familjeve Xheladini dhe Balaj heshtjen e tyre dhe mosndjekjen penale të UNMIK-ut në shkëmbim të kompensimit material.

Institucionet e drejtësisë, si dhe ato politike të Republikës së Kosovës, deri sot nuk kanë bërë asgjë për këtë çështje. Serioziteti i një shteti matet me përkushtimin e tij ndaj mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të vet, kur ato shkelen.

10 shkurti e ka parë deri sot krimin, manipulimin, shtrembërimin, njollosjen dhe përdhosjen. Por, 10 shkurti, më në fund, duhet ta shohë drejtësinë. Ne për fund i kemi përgatitur edhe një sërë konkluzionesh, të cilat do t'i paraqiten këtij Kuvendi për t'u votuar dhe të cilat do t'i prezantojë shefi i Grupit Parlamentar, Visar Ymeri. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë sipas radhës. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara familje Balaj dhe Xheladini,

Të nderuar ju që jeni të lënduar nga ajo demonstratë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të shprehim edhe ne shqetësimin dhe interesimin tonë që drejtësia lidhur me këtë rast të realizohet.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike edhe sot pas 6 vjetësh nga demonstrata e shkurtit të vitit 2007 ndjen keqardhje, Ndjejmë keqardhje për familjet Balaj dhe Xheladini, ndjejmë keqardhje për të lënduarit dhe familjet e të lënduarve në atë demonstratë, ndjejmë keqardhje posaçërisht që Partia Demokratike e Kosovës në atë kohë nuk ka qenë subjekt politik i pozicionuar asisoj në Qeveri që t'i parandalojë pasojat, sidomos pasojat të cilat janë shkaktuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme nga ndërhyrja policore e njërive të specializuara rumune.

Për më tepër, Partia Demokratike e Kosovës mendon se institucionet ndërkombëtare të administrimit të Kosovës, kompetente për administrimin e drejtësisë në këtë rast, nuk kanë bërë shumë, për të mos thënë nuk kanë bërë asgjë.

Edhe vetë e keni parë nga raporti se prokurori ndërkombëtar i çështjes, i cili i është drejtuar Përfaqësuesit Special, ka arritur në dy përfundime, të cilat janë të rëndësishme, mendoj unë dhe Partia Demokratike.

Paçka që raporti duket të jetë më tepër raport analitik, raport i karakterit profesional, i cili nuk reflekton hetime profesionale serioze, të vendosura lidhur me këtë rast.

Ato përfundime të rëndësishme, mendojmë ne, janë dy:

E para, zoti Dean, prokurori ndërkombëtar, e konstaton dyshimin e arsyeshëm, madje të bazuar, se atë ditë njësitë e specializuara të policisë rumune kanë bërë krim mbi demonstruesit. Ai ka dilema sa i përket kualifikimit apo cilësimit juridik të veprave që janë shkaktuar, ai ngre dilema në raport nëse ka ndodhur vrasja, nëse ka ndodhur vrasja nga pakujdesia, nëse ka ndodhur përpjekja për vrasje, apo në rastin e të lënduarve, nëse ka ndodhur lëndimi i rëndë. Pra, i ngre dilema, por, megjithatë, në fund del përfundimi se atë ditë është bërë krim ndaj pjesëmarrësve në demonstratën e 10 shkurtit 2007.

Përfundimi i dytë, po ashtu shumë i rëndësishëm, që na ofron afër së vërtetës është se atë krim, thotë ai, e ka bërë njësia specializuar e policisë rumune.

Për më tepër, ai shkon edhe më tutje dhe supozon se një apo dy profesionistë të asaj njësie të ashtuquajtur profesioniste, për mua s'kanë qenë të tillë, i kanë përdorur plumbat nëpërmjet të cilëve janë shkaktuar vrasjet. Pra, ai e ka ofruar të vërtetën shumë afër. Ndërkohë që këtu përfundon hetimi në emër të asaj se nuk ka pasur bazë juridike, në mungesë të kryesve të panjohur. Këtu supozojmë ne, si Grup Parlamentar, ka pasur ndërhyrje politike ndërkombëtare dhe diplomatike për t'i shpëtuar njësitë e policisë rumune. Dhe, këtu përfundon çdo gjë.

Ne mendojmë se drejtësia në këtë rast duhet të realizohet, së pari për hir të familjeve Balaj dhe Xheladini dhe të gjithë atyre familjeve që atë ditë kanë pësuar dhimbje nga lëndimet e të lënduarve në atë demonstratë.

Së dyti, mendojmë se i bëjmë mirë drejtësisë edhe në kuptimin njerëzor dhe filozofik të fjalës.

Dhe, së treti, bëjmë mirë edhe OKB-së dhe misionëve të ardhshme dhe të popujve, të cilët do t'i nënshtrohen, ishalla më pak, misionëve ndërkombëtare, në të cilat mund të vihet deri te keqpërdorimi jonjerëzor i autoritetit policor.

Ne si Grup Parlamentar jemi të vendosur që ta mbështetim Qeverinë, mbështetim institucionet ndërkombëtare të drejtësisë dhe ato vendore, diplomacinë tonë që drejtësia të realizohet edhe në këtë rast.

Mendojmë se ka mundësi, mendojmë se kërkesat apo veprimet konkrete të propozuara janë të realizueshme, disa ç'është e vërteta edhe mund të modifikohen, për të qenë krejt

sinqertë, sepse është një kërkesë aty që të mbahet një seancë apo të nxirret një rezolutë nga Asambleja e OKB-së, që të bëhet debat në OKB.

Ju e dini që madje as pas Sebrenicës, OKB-ja ka qenë shumë e shqetësuar. Prandaj, kam drojën se kjo mund të jetë e perealizueshme si kërkesë, ndërkohë që kërkesa kryesore rreth kësaj, që nëpërmjet Qeverisë shqiptare t'i kërkojmë OKB-së, kjo është e realizueshme. Prandaj, ne do ta mbështetim propozimin e veprimeve konkrete, edhe vetë si deputetë të Grupit Parlamentar individualisht në bazë të kërkesës tre, për veprime konkrete, në takimet tona me zyrtarë ndërkombëtarë ta ngremë gjithmonë këtë çështje, në mënyrë që të realizohet drejtësia.

Krejt në fund, më lejoni që të shpreh dëshirën e Partisë Demokratike që ky debat sot të karakterizohet, të përshkruhet me një diskurs njerëzor dhe profesional. Jo përtej kësaj. Kështu i bëjmë mirë edhe rastit si rast, edhe drejtësisë si drejtësi.

Ndërkohë që po i shfrytëzoj edhe gjysmë minute në emrin tim personal, meqë në atë kohë kam qenë pjesë e Policisë së Kosovës. T'i them dy gjëra:

E para, dëshiroj të besoj se familjet Balaj dhe Xheladini në asnjë rast nuk u ka qarë zemra, siç thotë populli, në Policinë e Kosovës. Të jeni të sigurt se Policia e Kosovës atë ditë ka qenë për herë të dytë e sfiduar shumë. Të jesh para atyre që në mënyrë joprofesionale e joligjore e përdorin dhunën ndaj qytetarëve tu, ndërkohë që ti je aty t'i ruash, është e vështirë. Këtë e kuptojnë vetëm ata që kanë qenë pjesë.

Dhe, e dyta, mendoj se i mbetemi borxh po ashtu Policisë, nëse nuk themi se ajo dhe disa deputetë të nderuar këtu, edhe të "Vetëvendosjes", janë të ndërgjegjshëm se disa pjesëtarë të Policisë së Kosovës kanë kontribuar në përpjekje për ta ndriçuar këtë rast, qoftë edhe individualisht.

Më lejoni të ju them me emocione, atë ditë ka pasur policë të Republikës së Kosovës, të cilët në mënyrë joprofesionale, të paligjshme, kanë qenë të gatshëm edhe të hakmerren. Shyqyr që s'e kanë bërë këtë. Por, megjithatë, dua të ju them se ky ka qenë mendimi individual i policëve për të qenë pjesë e popullit. Prandaj, e ndjeva për obligim, mund të mos jenë politike, por kjo është e vërteta për Policinë e Kosovës në vitin 2007, e cila me asgjë nuk ka pasur asnjë lloj kompetence që të merret me këtë çështje.

Uroj që debati të zhvillohet në diskursin, prapë po e përsëris, njerëzor dhe profesional. Kjo ishte personale. Faleminderit!

KRYETARI: Sa të mundni mos e personalizoni! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: I nderuari kryetar Krasniqi,
Të nderuar deputetë,
Të nderuara familje Balaj dhe Xheladini,

Fillimisht më lejoni që edhe një herë, në emër të LDK-së, juve familjarë të respektuar, të ju shpreh ngushëllime të thella për humbjen e më të dashurve tuaj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po bëhen më shumë se 6 vjet nga vrasja e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit dhe plagosja e lëndimi i mbi 80 protestuesve të tjerë.

6 vjet nga ky krim i Policisë së UNMIK-ut, përkatësisht njësisë speciale të policëve rumunë. 6 vjet pritje se më në fund drejtësia do të fillojë të veprojë, të veproj në atë mënyrë që vrasësit e Monit dhe të Arbenit të dalin para drejtësisë. Fatkeqësisht, ata që është dashur të veprojnë, nuk veproun.

Prania ndërkombëtare, në këtë rast e UNMIK-ut, e asaj kohe dhe policia ishin në Kosovë të mbajnë rend dhe ligj, por nuk kishin asnjë arsye dhe asnjë të drejtë të shtinë mbi protestues, të vrasin dhe lëndojnë, të lënë prindër pa më të dashurit, pa fëmijët e tyre, e fëmijë pa prindër. Nuk kishin asnjë arsye dhe asnjë të drejtë të gjymtojnë dhjetëra e dhjetëra protestues, qytetarë të Kosovës, për faktin se ata e shfrytëzonin një të drejtë elementare - të drejtën e protestës dhe shprehjes së pakënaqësisë, e drejtë kjo e njohur ndërkombëtarisht me të gjitha konventat ndërkombëtare, konventa e rezoluta të miratuara edhe nga vetë OKB-ja.

Ne jemi të vetëdijshëm se fajësia nuk është kolektive. Nuk është në këtë rast e tërë OKB-së, por është e urdhërdhënësve dhe kryesve të këtij krimi. Ata e kryen krimin dhe ikën pa ther në këmbë.

LDK-ja vlerëson se përgjegjësit për këtë krim, për vrasjet dhe plagosjet e 10 shkurtit 2007 nuk mund t'i mbrojë asnjë lloj imuniteti.

Jeta e njeriut është e shenjtë. Ajo fitohet me të lindur dhe garantohet me të gjitha konventat ndërkombëtare. Ne jemi të vetëdijshëm për faktin se në atë kohë me Kosovën ka udhëhequr UNMIK-u, përgjegjës ka qenë edhe policia e UNMIK-ut, përkundër faktit që ne i kishim institucionet tona të dala nga votat e qytetarëve.

Megjithatë, ne sot shprehim konsiderata të veçanta për zotin Fatmir Rexhepi, ministrin e atëhershëm të Punëve të Brendshme, nga radhët e LDK-së, për aktin e tij të lartë të përgjegjësisë, i cili pas këtyre ngjarjeve të dhimbshme si akt moral dha dorëheqje nga posti i tij. Ky gjest do të duhej të ishte shembull i përgjegjshmërisë dhe moralit të njerëzve kompetentë se jeta e njeriut është më e vlefshme se cilido post. Do të duhej të ishte shembull se interesat e qytetarëve, interesat e shtetit, jeta e qytetarëve janë më të rëndësishme se cilido post qoftë ai.

LDK-ja konsideron se është obligim, para së gjithash i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me ndihmën edhe të Qeverisë shqiptare, në këtë rast, që për këtë çështje, siç thuhet edhe në një rekomandim, të kërkohet dhe të debatohet edhe në të gjitha instancat kompetente ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Të veprohet konform rregullave dhe konventave ndërkombëtare dhe fajtorët të dalin para drejtësisë dhe ta marrin dënimin e merituar. Edhe raporti që u përmend edhe më herët nga kolegët, raporti i parë i prokurorit ndërkombëtar, zoti Dean, i 16 prillit 2007, edhe raporti i dytë dorëzuar më 29 qershor 2007, kanë të gjetura të mjaftueshme mbi të gjitha, e mbi të gjitha fakti se vrasjet kanë qenë, siç thuhet të shmangshme dhe sigurisht të pajustificueshme. Kjo është e mjaftueshme që për këtë të bëhet hetim i duhur profesional dhe fajtorët të përgjigjen. Aq më tepër se fakte dhe dëshmi konsiderojmë që ka, por ato duhet hetuar dhe duhet gjetur.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne e përsëritim edhe kërkesën, përkatësisht qëndrimin edhe e Amnesty Internacional, një organizatë e respektuar ndërkombëtare, e cila kërkon hetim dhe vënie para drejtësisë të fajtorëve për këtë krim.

LDK-ja konsideron se duhet shfrytëzuar të gjitha rrugët ligjore që kjo çështje ta marrë rrjedhën e duhur, ta marrë epilogun e duhur, e ai është dënimi i fajtorëve, sepse çdo veprim ndryshe është rrugë e hapur për krimet që ato të përsëriten, e kjo nuk duhet të ndodhë askund në botë në asnjë mision, aq më tepër misione me firmën paqësore. Paqja nga ata që duhet ruajtur kudo qofshin dhe krimi i bërë po nga ata, nuk shkonë bashkë.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar familjarë,

LDK-ja edhe një herë kërkon përgjegjshmëri, vendosmëri nga të gjitha institucionet kompetente, që hetimi për krimin e bërë të fillojë dhe të dënohen të gjithë ata që urdhëruan, por edhe e kryen krimin. Këtë ua kemi borxh familjeve, që i kanë humbur të dashurit e tyre, ia kemi borxh Kosovës, sado që e dimë se më të dashurit e tyre të vararë nuk kthehen, por sidoqoftë ky do të ishte një lehtësim shpirtëror, por është edhe një obligim yni ligjor dhe institucional. Drejtësia duhet të shkojë gjithsesi deri në fund.

Ne si Lidhje Demokratike e Kosovës i përkrahim rekomandimet e bëra dhe konsiderojmë që ato absolutisht të jenë të qëndrueshme dhe si të tilla edhe do t'i votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Për katër ditë pas 10 shkurtit të vitit 2007, UNMIK-u refuzoi të pranonte se policia e tij kishte shtënë me plumba gome. Kur kjo u bë e paqëndrueshme përfaqësuesi special i atëhershëm, Joakim Ruecker, kërkoi dorëheqjen e komisionarit britanik të Policisë së UNMIK-ut, Stephen Curtis. Përfaqësuesi special po ashtu e transferoi hetimin që ishte hapur nga policia e UNMIK-ut te Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut, nën udhëheqjen e prokurorit special të OKB-së, Robert Dean.

Prokurori Robert Dean prodhoi dy raporte bazuar në hetimin e tij, i pari i botuar në prill dhe i dyti në fund të qershorit të vitit 2007.

Raporti i parë i tij i hodhi poshtë të gjitha akuzat e rrejshme të UNMIK-ut, ambasadave dhe Grupit të Unitetit për kinse dhunën e ushtruar nga demonstruesit.

Dean deklaroi: “Asgjë në dëshmitë e deritanishme nuk lë të nënkuptojë se Mon Balaj, Arben Xheladini ose Zenel Zeneli kanë bërë ndonjë gjë që do të kërcënonte jetën e policëve ose të personave të tjerë në momentet kur ata u vranë”. Ai po ashtu arriti në përfundimin se vdekjet e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit ishin të panevojshme dhe të shmangshme. Po citoj sërish: “Duket se nuk ka asnjë justifikim për qëllimin në kokën e Mon Balajt, në kokën e Arben Xheladinit dhe në gjoksin e Zenel Zenelit”.

Në fund, Robert Dean shtoi: “Na mbetet të përfundojmë se përdorimi i plumbave të gomës atë ditë mund të ketë qenë pasojë e urdhrave të gabuar dhe e papërshtatshme në ato rrethana”. Dean, gjithashtu, i identifikoi ata që ishin drejtpërdrejt përgjegjës për vrasjen e Monit dhe të Arbenit. Ata u qëlluan, tha ai, me plumba gome RB1, të shtëna vetëm nga kontingjenti rumun. Por, Robert Dean qëllimshëm nuk shkoi përtej kësaj. Ai nuk i identifikoi individualisht policët rumunë, të cilët ishin dorasit e këtij krimi ndaj Mon Balajt, Arben Xheladinit, Zenel Zenelit, Mustafë Nerjovajt, Hysni Hysenit dhe 80 demonstruesve tjerë të plagosur atë ditë. Kjo që të mos mundësohej padia penale ndaj tyre.

Pavarësisht nga vendimi Dean-it, kontingjenti rumun nuk ishte më në Kosovë. Më 23 mars, disa javë para publikimit të raportit të Dean-it, UNMIK-u i kishte njoftuar mediet se njësia policore rumune ishte larguar disa ditë më parë. Në të vërtetë, edhe pse UNMIK-u ishte në dijeni që prej 12 shkurtit se policia rumune ishte fajtores, asnjë përpjekje nuk u bë për t’ua hequr atyre imunitetin.

Siç vuri në dukje Inspektorati Policor i Kosovës, policët rumunë nuk u morën në pyetje si të dyshuar, por vetëm si dëshmitarë. Dhe kishte shpërputhje në deklaratat e tyre gjatë dhënies së dëshmive.

Raporti i dytë Dean-it, i cili doli në qershor, e trajtonte në mënyrë të rëndësishme zinxhirin komandues dhe përgjegjësinë e UNMIK-ut. Dean konstatoi se të gjithë komandantët e policisë së UNMIK-ut, duke përfshirë edhe komandantin e parë, kishin deklaruar se nuk kishin qenë në dijeni për urdhrin për të përdorur plumba gome.

Në anën tjetër, komandanti i njësisë rumune deklaroi se kishin pasur autorizim për të përdorur plumba gome. Këto deklarata kontradiktore e çuan Dean-in në konkluzionin se plumbat e gomës ishin përdorur për shkak të një keqkuptimi rreth asaj se çfarë përbën një pajisje e plotë për ndërhyrje të shpejtë. Përfundimi i Dean-it krijoi kështu një huti rreth asaj se kush ishte përgjegjës në zinxhirin komandues. Ky konkluzion kundërshtohet nga Inspektorati i Policisë në raportin e vitit 2007. Ata vunë në dukje se gjithsej 232 plumba gome janë shkrepur trazirave, shumica e tyre pas lëndimit të katër personave me plumba gome mbi lartësinë e belit, dhe komandantët e UNMIK-ut duhet të ketë qenë në dijeni për këtë.

Në vitin 2008, Ombudspersoni i Kosovës theksoi se UNMIK-u nuk kishte marrë asnjë masë tjetër disiplinore kundër policisë apo zyrtarëve në zinxhirin e komandës.

Efekti i përgjithshëm i këtyre dy raporteve të Dean-it ishte pranimi i përgjegjesisë nga UNMIK-u, por duke shmangur përpjekjet për të provuar se cilët zyrtarë ishin përgjegjës në zinxhirin e komandës. Për më tepër, hetimet e tij e identifikuan njësinë e policisë përgjegjëse për gjuajtjen e plumbave vdekjeprurës, por, sipas tij, nuk mund të identifikohet asnjë i dyshuar, edhe nëse do t'i hiqej imuniteti.

Përgjegjësia këtu rëndon në 3 nivele.

Niveli i parë i përgjegjesisë penale rëndon në policët individualisht, pra dorasit e vrasjes dhe plagosjes së demonstruesve paqësorë.

Niveli i dytë i përgjegjesisë është ai i përgjegjesisë kolektive-operacionale, i cili rëndon mbi tërë kontingjentin e policisë speciale të UNMIK-ut, rumune por edhe të tjerëve të pranishëm atë ditë në terren, të cilët planifikuan, ekzekutuan dhe mundësuan këtë krim. Pra, edhe në zinxhirin komandues edhe në urdhërdhënie, por edhe në ekzekutim të krimit.

Dhe niveli i tretë është ai i përgjegjesisë politike, që rëndon mbi njerëzit kryesor të UNMIK-ut, kryeadministratorin Ruecker, zëvendësin e tij Stephen Schook, të cilët ia dhanë dritën e gjelbër intervenimit policor, por dhe Grupin e Unitetit e përfaqësues të caktuar të ambasadave të vendeve perëndimore, të cilët bashkë me UNMIK-un bënë çmos ta mbrojnë politikisht krimin, duke e pamundësuar kështu zbardhjen e tij dhe dënimin e kriminelëve.

Konventa mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara, 1946, thekson se ekspertëve të OKB-së (seksioni 22-23) u jepet imunitet nga procesi ligjor të çdo lloji për veprimet e bëra prej tyre gjatë kryerjes së misionit të tyre. Ky imunitet nga procesi ligjor vazhdon, edhe në qoftë se ata nuk janë më i punësuar në misione për OKB-në.

Megjithatë, Sekretari i Përgjithshëm e ka edhe të drejtën dhe detyrën për heqjen e imunitetit të një eksperti në çdo rast kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe ky imunitet mund të hiqet pa i cenuar interesat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Mosheqja e imunitetit natyrisht që në këtë rast e pengon rrjedhën e drejtësisë dhe është pikërisht ky mosveprim që i cenon interesat afatgjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, sepse e dëmton reputacionin dhe parimet e veta.

Ne nuk presim që OKB-ja do ta pranojë kërkesën tonë për një hetim të pavarur, por duhet t'ia bëjmë këtë kërkesë, sepse me rastin e 10 shkurtit UNMIK-u e ka hetuar tashmë vetveten. Zyra e Shërbimit të Mbikëqyrjes së Brendshme të OKB-së ka bërë edhe në raste tjera hetime të brendshme, për shembull, në rastin e abuzimit seksual në Republikën e Kongos. Në rastin më të mirë, Sekretari i Përgjithshëm do të mund ta emëronte një ekip hetues të pavarur, të udhëhequr nga një gjykatës i pavarur. E nëse OKB-ja refuzon ta

iniciojë një hetim të tillë, atëherë Kosova duhet ta emërojë vetë një ekspert të pavarur për ta hetuar rastin. Të paktën, kjo do ta kishte rritur presionin mbi OKB-në dhe Rumaninë për të bërë diçka në këtë drejtim në zbardhjen e rastit të vrasjes së 10 shkurtit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Është tepër e qartë se ky rast, kjo ngjarje tragjike, kjo ngjarje e krimit është emocionale për shumë prej nesh, sikur që është emocionale normalisht për gjithë popullin e Kosovës, por edhe për shumë prej nesh, të cilët kemi qenë të angazhuar në forma të ndryshme në situatën për të cilën po flasim.

Më lejoni që në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të Grupit Parlamentar të AAK-së të shpreh edhe një herë dhimbjen tonë për humbjen e Arben Xheladinit dhe Mon Balajt dhe po ashtu për dëmtimin, lëndimin e të tjerëve që ka ndodhur në atë ngjarje tragjike.

Është emocional kur po them fakti se një ngjarje e tillë e dhunshme definitivisht ka qenë e shmangshme, devinitivisht nuk ka pasur nevojë të ndodhë ashtu, devinitivisht nuk ka pasur kurrfarë nevoje, as profesionale, as policore, as të sigurisë për ta përdorur një dhunë të tillë nga policët e UNMIK-ut.

Më lejoni të bëj disa sqarime për të cilat besoj se ka nevojë ky Kuvend, populli i Kosovës dhe, tek e fundit, qëndrimet për të cilat do të duhet që edhe OKB-ja si administruese e Kosovës në atë kohë t'i ketë të qarta.

Shërbimi Policor i Kosovës në atë kohë ka qenë plotësisht jashtë planifikimit, ka qenë plotësisht jashtë organizimit dhe ka qenë plotësisht jashtë veprimit. Dhe, për këtë besoj se duhet ta them të qartë për shkak edhe të një varg veprimesh që ka bërë Shërbimi Policor i Kosovës në atë kohë, në kundërshtim gjatë ditës dhe pas asaj dite të ngjarjes së krimit.

Ministria e Punëve të Brendshme e Qeverisë së Kosovës në atë kohë nuk e ka pasur asnjë vit të themelimit të saj. E kemi të qartë, sikur u përmend edhe këtu, ministri i atëhershëm, zoti Fatmir Rexhepi, ka dhënë dorëheqje në baza morale, por mbi të gjitha ka dhënë dorëheqje për shkak të mungesës së informacioneve, për shkak të mungesës së dhënies së planit operativ edhe kur është kërkuar, për shkak të mungesës së përfshirjes së SHPK-së të atëhershme në planin operativ, për shkak të mungesës së çfarëdolloj autorizimi apo kompetence, që është dashur ta kenë institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës atëbotë.

Menjëherë pas kësaj dua të qartësoj se Ministria e Punëve të Brendshme e asaj kohe, pas zëvendësimit të detyrës së ministrit, kur ka ardhur zoti Blerim Kuçi, i ka angazhuar normalisht në formë të heshtur dhe pa bujë publike kontaktet e para me një ekip

avokatësh nga Londra për ta ndihmuar rastin. Dhe kjo besoj që ka qenë një prej elementeve më shumë morale të asaj se çfarë kemi bërë në atë kohë.

Rasti është trajtuar edhe në Panelin për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut. Rasti është trajtuar edhe prej krejt atyre që thanë kolegët e “Vetëvendosjes” në aspektin hetimor.

Rasti nuk është zgjidhur kurrë dhe këtë duhet ta theksojmë. Nuk është zgjidhur dhe është fjalë tepër e njohur ajo që thuhet se drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar në të njëjtën kohë.

Problemet e tilla të administrimit ndërkombëtar dhe misionëve paqeruajtëse që ka OKB-ja nëpër vende të ndryshme të botës, që prej vitit 1948, kur e ka pasur misionin e parë janë të vazhdueshme, por, si të tilla, nuk do të thotë se nuk ka mundësi që të ketë hetime dhe nuk do të thotë se ne duhet të heshtim, ose shtetet që janë anëtare dhe që janë partnerët tanë nuk mund të nxitin debate dhe hetime të tilla. Janë 2-3 nivele për të cilat duhet të adresojmë. Është edhe DPKU-ja, ose Departamenti për Operacione Paqeruajtëse, që funksionon në kuadër të Këshillit të Sigurimit, dhe në të njëjtën kohë është edhe Komisioni i Katërt për Politika Speciale dhe Dekolonizim në Asamblenë e Përgjithshme, i cili do të duhej të angazhohet në këtë çështje.

Më lejoni të qartësoj edhe një element se Korniza Kushtetuese ka qenë një prej çështjeve të ndjeshme në sektorin e sigurisë. Nuk ka pasur asnjë fjalë të vetme për qeverisjen dhe mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes të Kosovës. Pra, po flasim për një situatë, kur policia ka qenë e UNMIK-ut.

Të gjithë i dimë, por me qëllim po i përsëris për ta adresua mënyrën se si ne mund t’u qasemi veprimeve të mëtutjeshme.

Qeverisja dhe mbikëqyrja e sektorit të sigurisë së asaj kohe ka qenë totalisht në duart e PSPS-së, respektivisht komisionarit të policisë së UNMIK-ut, derisa Shërbimi Policor i Kosovës ka qenë në kuadër të policisë së UNMIK-ut. Pra, janë shumë mësimë që OKB-ja mund t’i nxjerrë nga rasti tragjik dhe kriminal që ka ndodhur më 10 shkurt 2007. Në të njëjtën kohë, ne duhet të themi qartë se këto mësimë nuk mund të nxirren nëse nuk ka hetim, nëse nuk ka adresim të përgjegjësisë, nëse nuk ka përgjegjësi për autorët e krimit.

E kemi të qartë po ashtu se ka qenë një kërkesë e UNMIK-ut dhe në të njëjtën kohë një kërkesë, jo vendim ose rezolutë, të Këshillit të Sigurimit të OKB-së qysh në vitin 2007, që policët rumunë të mos e lëshojnë Kosovën. Ajo kërkesë nuk është respektuar dhe policët rumunë e kanë lëshuar Kosovën. Prandaj, është e domosdoshme dhe e nevojshme që rasti të vazhdojë më tutje dhe insistimi ynë të jetë edhe më i fuqishëm, që rasti të hapet në hetim special nga Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme.

E dimë fare qartë se situata për të cilën po flasim ka qenë pak kohë pas publikimit të parë të Planit të Ahtisarit.

Përgjegjësini politike të pjesës së përgjithshme të negocimit në Vjenë në procesin e Vjenës e ka pasur Ekipi i Unitetit, në të cilin kanë qenë të përfaqësuara të gjitha partitë politike dhe shoqëria civile.

Si ambient politik, me qëllim po e përsëris, demonstrata e tillë, të paktën unë kam qenë pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme në atë kohë, asnjë moment, asnjë sekondë nuk e kemi parë se ka qenë kundër Qeverisë të Kosovës. Në asnjë moment dhe asnjë sekondë nuk e kemi parë ose nuk e kemi menduar që ajo demonstratë paska qenë kundër Kosovës. Përkundrazi, ne besojmë se veprimet e tilla të policisë së UNMIK-ut kanë pasur për qëllim, ndoshta krejt politik, për ta dëmtuar Kosovën, për ta dëmtuar procesin nëpër të cilën kalonte Kosova në atë kohë dhe për ta dëmtuar situatën e brendshme dhe solidaritetin e njerëzve brenda Kosovës.

Prandaj, më lejoni edhe një herë të them se duhet të nisë një hetim special sa më shpejt që të jetë e mundur për t'i adresuar direkt fajtorët dhe për t'i vendosur para drejtësisë. Është i domosdoshëm.

Ne mund të flasim dhe të koordinohemi edhe për konkludimet që dalin nga ky debat, për të cilin ne, si Grup Parlamentar i Aleancës, mendojmë se do të duhet të paktën të mundohemi të shmangim emra të përveçëm të shteteve, por që Qeveria e Kosovës t'i gjejë mënyrat e duhura për ta nxitur debatin dhe për të mundësuar një hetim nga OKB-ja për rastin në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje familjarë të Arben Xheladinit dhe Mon Balajt dhe të gjithë të lënduarve në këtë protestë të vitit 2007.

Përshëndetje për deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Shpresoj që do të jetë shumë e dhembshme ne të diskutojmë sot në mënyrë politike për jetën e dy qytetarëve tanë, të cilët në kohën më të mirë humbën jetën e tyre. Dhe, shpresoj që ngushëllimi më i madh i familjarëve të tyre dhe i të lënduarve në këtë demonstratë të jetë realizimi i drejtësisë në favor të familjarëve Xheladini dhe Balaj dhe të gjithë të lënduarve tjerë.

Është keqardhje edhe nga vetë deputetët e Koalicionit për Kosovë të Re, që të flasim para familjarëve për këtë rast, për arsye se në atë kohë Administrata Ndërkombëtare e UNMIK-ut, thuajse nuk ka bërë asgjë në këtë rast për të vënë drejtësinë në pah.

Mbështesim që shteti i ri i Kosovës, në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore t'u mundësojë familjeve Xheladini dhe Balaj dhe të gjithë të lënduarve në protestën e 10 shkurtit 2007, që drejtësia të vijë në vendin e duhur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Zoti kryetar i Kuvendit,
Zonja dhe zotërinj deputetë,
Të nderuar familjarë të rënëve,
Një motiv shumë i fuqishëm, që më nxiti të flas sot, përveç atij kryesorit të kërkimit të drejtësisë, është ofendimi i rëndë që kam ndjerë më 10 shkurt 2007, në periudhën pasuese e që vazhdoj ta ndjej edhe sot.

Ofendimi që i është bërë vendit tim, popullit tim dhe mua si pjesë e tij dhe ky ofendim është bërë nga UNMIK-u dhe strukturat e tij përgjegjëse për atë që ka ndodhur atë ditë. Unë personalisht kam qenë pjesë e asaj demonstrate, përmes së cilës kam dashur ta artikuloj pakënaqësinë time me atë që po ndodhte e që po i përgatitej Kosovës.

Si pjesëmarrës i këtij manifestimi protestues, mund të dëshmoj se në asnjë moment nuk ka pasur veprime e rrethana që do ta justifikonte një ndërhyrje të tillë brutale, shtazarake nga ana e strukturave të UNMIK-ut. Kjo ndërhyrje ka qenë jashtëzakonisht e ekzagjeruar dhe në shpërputhje të plotë me shkallën e nevojshme për ruajtjen e sigurisë. Por, kur kësaj i shtohet vrasja e dy njerëzve në rrethana krejtësisht të pajustificueshme, atëherë poshtërimi arrin kulmin.

Ofendimi më i madh vjen nga mënyra se si ne jemi trajtuar si popull në përgjithësi dhe si demonstrues në veçanti. Për fat të keq, shumë pjesëtarë të strukturave ndërkombëtare këtu, Kosovën e kanë konsideruar si oazë afrikane në Evropë dhe në këtë mënyrë disa prej tyre edhe janë sjell ndaj nesh, duke na konsideruar si rebelë të pashpresë, njerëz të paaftë për t'u sjellë në liri dhe për të menaxhuar me vetveten. Janë sjellë edhe pa ndjenjën më të vogël njerëzore e të përgjegjësisë.

Dikujt mund t'i duket e ekzagjeruar, por për fat të keq, kjo po vazhdon të ndodhë edhe sot. Kemi dy njerëz të vrarë, pa kurrfarë prove justifikuese dhe ende pas gjashtë vjetësh, askush nuk është vënë para drejtësisë për këtë krim mizor, përkundrazi, për ironi, kriminelët janë dekoruar.

Po sikur këta policë ta kishin vrarë një qytetar të një vendi tjetër të fuqishëm evropian, athua do të ndodhte e njëjta gjë? Përgjigjen për këtë, ju lutem, le t'ia themi secili vetes, në mënyrë që të jemi më të sinqertë.

Të nderuar deputetë, Kosova nuk është duke jetuar në mesjetë dhe qytetarët e saj nuk janë skllevër, që të konsiderohen si gjëra që flasin. Në qoftë se, ne heshtim dhe dorëzohemi para atyre që na trajtojnë si të tillë, ne do ta meritojmë atë trajtim. Prandaj, detyra jonë është që si institucione të këmbëngulim dhe t'i shfrytëzojmë të gjithë mekanizmat politikë e juridikë, për t'i mbërthyer kriminelët para drejtësisë. Në këtë betejë për drejtësi nuk humb asnjë popull, asnjë institucion. Në këtë betejë humb vetëm padrejtësia.

Nuk ka dyshim, që faktori ndërkombëtar është shumë merituar që Kosova sot gëzon këtë liri, por këtë liri nga pushtuesi nuk mund të lejojmë ta paguajmë me çmimin e lirisë kolektive e individuale, për të shprehur bindje politike, lirisë për të dalë si qytetarë të

Kosovës, për të shprehur pakënaqësinë përmes manifestimeve të ndryshme protestuese, është çmim shumë i lartë.

Në qoftë se, liria nga pushtuesi, pra e drejta për jetë nuk e nënkupton edhe të drejtën për jetë më të mirë, thjesht nuk ka vlejtur të përpiqemi për të. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të nderuara familje të Mon Balajt dhe Arben Xheladinajt dhe ju të nderuar të tjerë të pranishëm vendorë dhe ndërkombëtarë,

Unë këtë temë e kam trajtuar në këtë Kuvend edhe një herë, me rastin e emërimit të komandantit të njësisë speciale të EULEX-it, me përkatësi rumune. Dhe, sot do të përpiqem ta trajtoj nga aspekte, të cilave nuk mund t'u ikë asnjë nënshtetas i Kosovës dhe veçanërisht bashkëkombësit e Mon Balajt dhe Arben Xheladinajt.

Aspekte, së pari janë të dhembjes që i bashkëndejmë me familjet e të vrarëve dhe të gjymtuarve e të plagosurve tjerë, që janë më tepër se 80, sepse ka edhe të tjerë, që nuk janë paraqitur, për faktin se kam qenë pjesë e asaj proteste dhe për faktin, që në të ardhmen çdo organizator që do të marrë përsipër organizimin e një proteste dhe një pakënaqësie të këtij vendi dhe të këtyre masave të vendit tonë, të ngris aspektet menaxhuese të protestës dhe të ndajë detyrat edhe rolet e të gjithë organizatorëve, sepse është në interes të vetë organizimit, të vetë qëllimit dhe të qytetarëve, të cilët marrin pjesë aty, po veçanërisht edhe të misionit, për të cilin niset organizimi i protestës.

Unë atëherë, sikur edhe shumë qytetarë që ishin në protestë, ishim të shqetësuar për fatet e vendit. Gjithashtu edhe në Partinë Demokratike ishte një klimë, e cila motivonte dhe inspironte në një protestë të mundshme, për arsye të shumta.

Dhe, natyrisht bashkë me shumë bashkëpunëtorë të mi, ne u gjendëm në atë protestë e cila përfundoi dhunshëm dhe u vulos me një përgjakje të dhembshme, e cila nuk e mori kuptimin që e meritonte dhe mori zhvillime të paparashikueshme.

Ne së pari do të trajtojmë sot aspektin e dhimbjes, e cila edhe sot është vështirë, me një qasje institucionale, të zbutet dhe të shpërblehet. Të insistojmë institucionalisht që kjo dhimbje të marrë edhe ndëshkimin e atyre që e krijuan së bashku me ndihmën e institucioneve ndërkombëtare, të cilat janë përgjegjëset kryesore në shkaktimin e kësaj dhimbjeje.

Aspekti tjetër është ai që më shtynë mua, sepse kjo ngjarje goditi marrëdhëniet e popullit tonë dhe të popullit rumun, marrëdhënie të cilat kurrnjëherë nuk kishin qenë në konflikt, as për interesat tona reciproke dhe as për interesa të të tjerëve, sepse deri më këtë rast populli shqiptar dhe populli rumun, asnjëherë, në asnjë etapë të historisë së tyre, aq sa kemi mësuar nga historia dhe aq sa mbajmë mend nga gjithë mësimet që kemi prej saj, kurrnjëherë, asnjë zhvillim të dhembshëm dhe asnjë fërkim dhe asnjë përplasje mes tyre

nuk ka ekzistuar, përkundrazi, në librat e historisë, në kujtesën tonë historike, në mbamendjen tonë njerëzore, gjithçka që kujtojnë raportet tona me rumunët dhe me Rumaninë, janë jashtëzakonisht kujtime të mira, konsiderata të veçanta dhe marrëdhënie miqësore. Madje, veçanërisht prej shteteve, veçanërisht prej popujve tjerë, në kthesa, në rrugëkryqe dhe në zhvillime historike, kur ka pasur populli ynë, Rumunia dhe populli rumun i është gjetur në krah popullit shqiptar dhe madje i ka krijuar hapësirë, mundësi dhe strehë shumë korifenjve të Rilindjes Kombëtare, për të përgatitur edhe shumë akte, për të ardhur deri te akti i shpalljes së pavarësisë.

Shumë nga mendimtarët, shumë nga rilindësit, shumë nga veprimtarët në historinë tonë dhe sidomos, në kohën e Rilindjes, kur gjithçka ishte ngulfatur dhe ishte e pamundur në atë kohë, në vendin tonë të zhvillonin veprimtari botuese, në Rumuni dhe në kryeqytetin e saj, shumë prej bashkëkombësve tanë gjetën hapësirë dhe mundësi, i krijuan mbështetje dhe i përkrahën rumunët dhe shteti i Rumanisë, që ata të krijojnë veprimtari botuese, për të përhapur rrezet e lirisë dhe frymën e pavarësisë së vendit tonë.

Nuk mbaj mend as unë dhe nuk gjejmë të shkruar as në historinë tonë, që edhe për motive në përkrahje të interesave të tjerëve, populli rumun dhe shteti i Rumanisë, të jetë gjetur në konflikt me popullin shqiptar.

Tani, në këtë demonstratë, në këtë ngjarje të dhimbshme atëherë, në një protestë të ligjshme të njerëzve, nënshetasve të Kosovës, të cilët ishin të brengosur për një etapë dhe që ishte pak a shumë e mundshme për të eskaluar në forma dhe në mundësi të padëshirueshme, në akceptimin e nevojave të këtij populli, për ta institucionalizuar vullnetin e tij, u gjendën një grusht rumunësh, u gjendën disa pjesëtarë të Policisë së Rumanisë, të cilët i zbrazën armët në gjokset e të rinjve tanë lirisdashës dhe me vullnet mëvetësie, të cilët kishin dalë veçse për të kërkuar diçka që ishte e ligjshme dhe për të protestuar, për diçka që ata kishin shumë të drejtë.

Me këtë rast edhe mund të ketë qenë kapriçio individuale edhe mund të ketë qenë ngarkesë e pjesëtarëve të policisë me përkatësi jorumune, por shteti i Rumanisë dhe populli rumun ka mbetur në konflikt me neve pas kësaj ngjarjeje, e cila do të duhej t'i bënte të reflektonin ata edhe me një konstruktivitet institucional edhe më të matur, ashtu siç i ka hije një shoqërie të emancipuar dhe një shteti me demokraci të konsoliduar dhe natyrisht, jo t'i tërhiqnin ashtu siç i tërhoqën pjesëtarët e kësaj njësie speciale, por natyrisht, t'i nxjerrin para përgjegjësisë individuale, sepse të gjithë ata nuk kanë vuarë, por ata të cilët do të gjendeshin penalisht përgjegjës për vrasjet dhe plagosjet e rënda, që ndodhën këtu.

Me këtë rast, kjo ngjarje na ka shkaktuar një dhembje dhe na ka shkaktuar një incident dhe një aksident me këtë shoqëri, e cila në mbamendjen tonë, në librat e historisë mbahet mend veç për të mirë. Ky rast tani na ka krijuar edhe një mundësi për ta diskutuar tani dhe gjithnjë, sa herë të nxjerrim këtë temë në trajtim.

Asnjë pjesëtar i Policisë së EULEX-it, sidomos në pozita komanduese nuk bën të emërohet, as nga shteti i Rumanisë, i cili nuk ka njohur shtetin e Kosovës, por as edhe

nga shtetet e tjera, të cilat ende hezitojnë ta njohin shtetin e Kosovës. Republika e Kosovës, nga ato shtete që nuk është njohur, kurrë asnjë qytetar i tyre nuk do të punojë për të mirën e këtij vendi dhe kurrë nuk do të jetë në shërbim të misionit paqësor edhe të atij koncepti, që është konceptuar në të gjitha institucionet e emancipuara, që janë si në OKB e deri në Bruksel.

Me këtë rast edhe njëherë kërkoj që të gjithë bashkërisht ta trajtojmë me kujdes këtë dhimbje dhe ta definojmë një kërkesë e cila edhe është e pranuar edhe është e administruar edhe e ndihmon nxjerrjen para përgjegjësisë penale të gjithë atyre vrasësve, që nesër mund të jenë kontingjente vrastare në një vend i cili kërkon liri dhe një popull, i cili ka nevojë për ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare.

Edhe një herë, respektin më të madh nga unë dhe nga gjithë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për familjet e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara familje,

Unë dola këtu për të marrë fjalën sot, për të shprehur ngushëllime ndaj familjes dhe për të shprehur solidaritetin tonë, për njerëzit që u vranë në të drejtën e tyre për të protestuar dhe në të drejtën e tyre për të dhënë një kontribut në rrugën që ata mendonin.

Ne sot mund të bëjmë dy gjëra: e para është që të shprehim respekt dhe solidaritet - respekt për të rënit dhe solidaritet me familjet; dhe e dyta që të angazhohemi si Kuvend që të shohim rrugët dhe mundësitë, mbi bazën e të cilave mund të vendoset drejtësia në vend.

Drejtësia nuk është vendosur për këtë çështje dhe ky është shqetësim yni i përbashkët, besoj i të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ky shqetësim i përbashkët është edhe angazhim i përbashkët, sepse këtu u dha përkrahja nga të gjitha grupet parlamentare, për rekomandimet që do të dalin në fund, që do të obligohen, megjithëse ne si deputetë e kemi marrë me kohë dhe unë si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, jap përkrahje për këto rekomandime dhe besoj se duhet të angazhohemi bashkërisht për të vendosur drejtësinë.

Jo pse ne mund të bëjmë diçka për të vendosur drejtësinë, mirëpo ne mund të kërkojmë, që drejtësia të vendoset nga institucionet të cilat kanë për detyrë që ta vendosin drejtësinë.

Në këtë rast flitet për institucionet mbinacionale. Nuk bëhet fjalë për institucione të Kosovës, të cilat mund ta vendosin drejtësinë, po bëhet fjalë për institucione të drejtësisë ndërkombëtare. Dhe, me këtë rast duhet të merret Organizata Kombeve të Bashkuara dhe ata ta trajtojnë më me seriozitet, sepse edhe raportet dhe hulumtimet, që i kanë bërë ata, sepse unë po i quaj raporte dhe hulumtime se nuk ka pasur një hetim të mirëfilltë, sepse kur mbyllet një hetim i mirëfilltë, jepet një pasojë. Dhe, pasojë nuk është prodhuar, nuk është prodhuar ndjekje penale për personat që kanë kryer veprën penale të shpërdorimit të forcës, ose të përdorimit të forcës së tepruar me pasojë vdekjen e protestuesve. Dhe, në këtë rast, duke mos pasur një pasojë, unë po e quaj raport për hulumtim dhe jo hetim.

Dhe, ajo çka ne po kërkojmë, është një hulumtim profesional dhe nxjerrje para drejtësisë personave, të cilët kanë marrë pjesë në këtë akt, i cili ka prodhuar pasoja, humbjen e jetës së njerëzve të pafajshëm, të cilët ishin në të drejtën e tyre, duke protestuar për një kauzë, për të cilën besonin se është kauzë e drejtë.

Edhe një herë, si përfundim, unë do të përkrah rekomandimet që kanë ardhur dhe u shpreh ngushëllime familjeve të të rënëve dhe jemi në një situatë, ku pak mund të bëjmë si Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Më 11 tetor 2007, nga familja e Arben Xheladinit dhe Mon Balajt, si dhe të lënduarit Zenel Zeneli dhe Mustafë Nerjobaj, u parashtrua ankesë në Panelin këshillues për të Drejtat e Njeriut për rastin e 10 shkurtit.

Paneli këshillues për të Drejtat e Njeriut është e vetmja instancë juridike, ku mund të parashtrohen ankesa ndaj punonjësve të UNMIK-ut, për shkak të imunitetit të tyre, në rastet kur këta të fundit shkelin të drejtat e njeriut.

Por, ky panel ka rol këshillues, pra vendimet e tij nuk janë të detyrueshme, pasi që OKB-ja nuk është e obliguar që t'i bindet vendimeve të panelit. Gjithashtu, edhe pse gjykatësit në këtë panel janë të pavarur, paneli si organ është nën autoritetin e UNMIK-ut.

Më 10 shkurt 2007 u shkelën një numër i madh i të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut, shkelje këto të cilat përmenden edhe në ankesat e familjarëve të Arben Xheladinit dhe Mon Balajt. Së pari u shkel e drejta e jetës, pra me vrasjen e të ndjerëve.

Ankuesit pretenduan që nuk kishte asnjë justifikim për të shtënat. Gjithashtu, ata pretenduan që nuk kishte asnjë justifikim për përdorimin e plumbave të gomës, madje përdorimi i tyre ishte në kundërshtim me Udhëzimin për përdorimin e plumbave të gomës. Këtu dua të shtoj faktin, që në korrik të vitit 2007, domethënë pesë muaj pas demonstratës së 10 shkurtit, OKB-ja e përjashtoi përdorimin e plumbave të gomës në Kosovë dhe paralajmëroi se planifikon t'i heqë ato në gjithë misionet e OKB-së, pra në botë. Pra, kjo demonstratë pati ndikim universal.

Së dyti, ankuesit pretenduan shkeljen e së drejtës për jetën, ku u dështua që në mënyrë të drejtë të hetohet vrasja e të ndjerëve. Ankuesit pretenduan, se hetimet nga policia e UNMIK-ut dhe prokurori special i UNMIK-ut nuk ishin të pavarura dhe se ata nuk arritën të identifikojnë, apo të ndjekin penalisht dhe të dënojnë ata që janë përgjegjës për vrasjet.

Gjithashtu, policia e UNMIK-ut dhe prokurori special nuk arritën të mbledhin të gjitha dëshmitë relevante, nuk arritën t'i intervistojnë oficerët e Policisë rumune, si të dyshuar dhe nuk arritën të intervistojnë të gjithë të dyshuarit, apo dëshmitarët përkatës.

Së treti, ankuesit pretenduan një shkelje të së drejtës për të qenë të lirë dhe për t'u trajtuar në mënyrë njerëzore. Ata argumentuan se forca e përdorur nuk ishte e justifikuar dhe hetimi në përdorimin e forcës ishte i pamjaftueshëm.

Së katërti, ankuesit pretenduan një shkelje të së drejtës për një proces të drejtë dhe të drejtën për një zgjidhje efektive, sepse raportet e Prokurorisë Speciale nuk çojnë në një hetim penal, apo në një ndjekje penale.

Dhe së fundi, ankuesit pretenduan një shkelje të së drejtës për t'u mbledhur në mënyrë paqësore.

Është e rëndësishme që të theksohet se ky rast është duke u përfaqësuar falas nga një ekip i avokatëve, pra Avokatura Took's Chambers, e cila është e njohur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pra në bashkëpunim me avokatin vendor të rastit Halim Sulejmani, kanë punuar edhe Paul Troop, Jude Bunting, Jesse Nicholls, Fouzia Khan, Richard Reynolds, Greg O'Ceallaigh dhe James Mehigan.

Që nga viti 2007 ka pasur ndërhyrje të vazhdueshme politike të PSSP-së në punën e panelit, me qëllim të përjashtimit të këtij rasti dhe me qëllim të pengimit të drejtësisë. Si pasojë e këtyre ndërhyrjeve, sot në vitin 2013 paneli është ende duke e shqyrtuar rastin dhe pritet një vendim prej tij.

Por, vetë fakti që paneli vazhdon të shqyrtojë këtë rast dhe nuk ka hequr dorë nga ky rast, është një arritje e madhe, që tregon për vendosmërinë e ankuesve në kërkim të drejtësisë.

Paneli e shpalli rastin të pranueshëm më 6 qershor 2008. Pas pranueshmërisë së rastit nga ky panel, PSSP-ja fillimisht tentoi të pengonte pranueshmërinë e tij e më pas bëri një varg letrash, duke argumentuar se rasti nuk duhej të pranohej, pasi që UNMIK-u ende nuk kishte mbaruar procesin e kompensimit. Dhe, sipas rregulloreve të OKB-së, kompensimi jepet vetëm për humbjet ekonomike, por jo edhe për dhimbjet, vuajtjet apo ankthet.

Pra, PSSP-ja deklaroi që nuk janë shterur të gjitha rrugët në dispozicion, për shqyrtimin e rastit dhe se paneli duhet të ndërpresë punën.

Në verë të vitit 2009, PSSP-ja u ofroi kompensim familjeve në emër të OKB-së, por me kusht që ata të hiqnin dorë nga e drejta e tyre ligjore, mirëpo, kur familjet nuk pranuan të heqin dorë nga kërkesa e tyre e vazhdueshme për një hetim penal dhe të drejtë dhe kur

Organizata për të Drejtat e Njeriut si Amnesty International shprehu shqetësimin e vet, PSSP-ja hoqi dorë nga ky kusht.

Mirëpo, pas kësaj, në tetor të vitit 2009, PSSP-ja shfrytëzoi pushtetin e tij ekzekutiv për të nxjerrë një udhëzim administrativ, që shpallte të papranueshëm çdo rast që është duke u shqyrtuar për kompensim nga OKB-ja. Ky udhëzim administrativ i ndryshoi rregullat ekzistuese të punës së panelit, duke ia mohuar kështu të drejtën panelit për t'i shqyrtuar rastet, që në të njëjtën kohë janë duke u shqyrtuar për kompensim nga OKB-ja.

Në pranverë të vitit 2007 UNMIK-u kishte hapur rastet e kompensimit për të gjithë të përfshirët në rastin e 10 shkurtit 2007 dhe më 17 tetor 2009, PSSP-ja lëshoi urdhëresë administrative dhe kjo urdhëresë deklaroi se:

- Procedura para panelit duhet të jetë jokundërshtuese,
- Çdo ankesë në panel, që është ose mund të bëhet në të ardhmen nga palët e treta, duhet të konsiderohet si e papranueshme, dhe
- Nëse një kërkesë është pranuar nga paneli, paneli është i detyruar që të rishikojë pranueshmërinë e asaj ankese apo atij rasti, dhe e fundit
- Çfarëdo ankese e marrë pas afatit të 31 marsit 2010 duhet të konsiderohet e papranueshme.

Si pasojë e kësaj rregulloreje, më datë 31 mars 2010, paneli i shtetit u detyrua që të shpallte rastin e 10 shkurtit si të papranueshëm, duke anuluar kështu vendimin e tyre të mëparshëm, por edhe duke qenë i vetëdijshëm se UNMIK-u kishte shkelur në mënyrë të hapur parimet bazë të drejtësisë.

Paneli gjithashtu, ruajti të drejtën e familjeve për të riparaqitur rastin e tyre pas procesit të kompensimit dhe me një procedurë të veçantë, pas afatit të caktuar nga UNMIK-u, që ishte 31 mars 2010.

Më 17 dhjetor, familjarët e të lënduarit e paraqitën ankesën e tyre në PKDNJ, pra në këtë panel, pra pas përfundimit të procesit të kompensimit dhe PSSP-ja përsëri vazhdoi ta arsyetojë se rasti është i papranueshëm dhe duke arsyetuar se ankesa është jashtë afatit, pra 31 marsit 2010 dhe që me pranimin e kompensimit ankuesit duhet të heqin dorë nga çfarëdo ankese tjetër. Por, paneli refuzoi të gjitha argumentet e PSSP-së dhe shpalli me vendim unanim të pranueshëm rastin më 11 maj 2012.

Aktualisht, paneli është duke u marrë me shqyrtimin e rastit dhe ne presim vendimin e tyre, por siç e përmenda edhe më herët, PSSP-ja nuk është e obliguar t'i zbatojë rekomandimet e panelit rreth rastit.

Prandaj, do të ishte shumë e rëndësishme ndihma politike e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe institucioneve përkatëse të Republikës së Kosovës, që të bëjnë presion ndaj UNMIK-ut dhe nëpër shtetet tjera, në mënyrë që OKB-ja t'i respektojë rekomandimet këshilluese të panelit, kurdo që ato do të ndodhin.

Gjithashtu në fund, duke pasur parasysh presionin e vazhdueshëm politik për këtë rast, është e rëndësishme mbështetja e Kuvendit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, për të pamundësuar presionin politik nga ana e UNMIK-ut, ndaj panelit gjatë kohës së marrjes së vendimit të tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar pjesëtarë të familjeve të goditura, të dëmtuara në protestën e 10 shkurtit, Më lejoni që t'ju përshëndes dhe t'i përshëndes edhe bartësit e nismës për këtë debat. Unë e mirëpres këtë debat, sado që nuk jam i bindur se debati është qasja më e mirë për problemet, që kohëve të fundit po i shtrojmë shpesh në Kuvend.

Kanë këto gjithësi rëndësinë e vet, por nuk besoj se janë të natyrës që duan shumë fjalë, shumë sentimente, sepse ato ashtu-kështu janë brenda tyre. Ajo që na ka munguar është qasja adekuate, institucionale, profesionale, që do t'i vente ato në rrugën e zgjidhjes.

Dhe, kjo për mendimin tim na ka munguar dhe nuk e përjashton edhe rëndësinë e mbështetjes edhe në debate të përgjithshme shoqërore. Por, për mendimin tim, do të ishte mirë që të fokusohemi në shkaqet e tyre, që eventualisht të shërbenin si mësim për të ardhmen.

Unë do të theksoj vetëm dy-tri fakte të kësaj natyre. Së pari koha, momenti kur kjo situatë u krijua që prodhoi edhe aq shumë dhimbje dhe aq shumë probleme pastaj në të ardhmen.

Dokumenti i Ahtisarit, që për ne edhe është historik dhe u vlerësua si i tillë, po për shkak të rëndësisë historike nuk u trajtua edhe ajo që ishte brenda, ajo që siç thonë: “djalli fle në detaje”. Dhe, tani ne po bindemi se ka pasur arsye për protestë, që nuk mund t'i referohen gjithë dokumentit në tërësi edhe pjesës pozitive, po se kishte çështje që mund të prodhonin tensione, ishte e qartë për secilin që do ta lexonte që në fillim. Dhe, kjo tash s'do duhej ndoshta të përmendej, po të mos ishte fenomeni që ne na përsëritet e njëjta gjendje.

Na përsëritet prirja për një qasje të njëanshme edhe sot kur i trajtojmë aspekte të veçanta të këtij dokumenti, po e përsëris për Kosovën, historik, por edhe problematik, me formula që janë të mbarsura me rreziqe për të ardhmen për përplasje, të cilat nëse nuk i korrigjojmë dhe nëse nuk i trajtojmë me përgjegjësi, do të jenë gracka edhe për brezat e ardhshëm.

E dyta, u tha këtu me të drejtë që ishte një ndërhyrje e pajustificueshme, është vlerësuar kështu edhe nga raporti i zotit Din, e policisë së UNMIK-ut, por mendoj që kjo nuk do të duhej dhe është mirë që në këtë debat nuk po çon në një si të thuash, përgjithësim të gjithë pranisë së UNMIK-ut, madje as të shteteve prej të cilave vinin policia, sepse mendoj që edhe nuk do të ishte mirë të ndodhë kjo. Nuk do të ishte mirë që qëndrimi kritik ndaj një veprimi, ndaj një segmenti, të përgjithësohet pastaj në gjithë misionin

ndërkombëtar, praninë ndërkombëtare, sepse megjithatë Kosova do të duhej, përkundër qëndrimit kritik e të përgjegjshëm, që i duhet, ta ruajë edhe qëndrimin kooperues dhe mirënjohjen për kontributin pozitiv që ka pasur prania ndërkombëtare dhe misioni i UNMIK-ut, madje edhe policia ndërkombëtare në Kosovë.

Do të duhej dalluar ajo që është e pranueshme, pozitive dhe do të duhej përkrahur, mbështetur, falënderuar edhe ajo që ishte gabim, që ishte e dëmshme, e cila do të duhej kundërshtuar me mjetet adekuate. Por, s' do të mund të harronim edhe një fakt, që edhe në atë protestë ka pasur një fenomen, të cilin unë e kam pas theksuar që në kohën kur ka ndodhur, një prirje e policisë sonë për të imituar sjelljet policore të mëhershme. Për fat të keq ka ndodhur ajo dhe është përsëritur, për fat të keq, edhe më vonë në situata të ngjashme, që e bën të domosdoshme të sqarohet ç'është e drejta e protestës, e cila duhet respektuar. Dhe, nuk ka qenë vetëm, si të thuash, ndërhyrja policore, jo më pak e rrezikshme e problematike ka qenë ndonjëherë edhe reagimi politik i pamatur, sepse reagimi politik i pamatur ndonjëherë, çon pastaj edhe në veprime të pamatura të policëve që janë ekzekutues dhe më pak mund të fajësohen ata.

Do të duhej krijuar kultura e protestës edhe nga ata që organizojnë protestën, por pastaj edhe trajtimin institucional të protestës, si një e drejtë universale e pamohueshme qytetare, e cila do të duhej edhe të trajtohej dhe të menaxhohej si e tillë.

Dhe, çështja e tretë të cilën do të dëshiroja ta theksoj, është - janë krijuar edhe pasoja të rënda. A janë trajtuar siç duhet ato pasoja, a janë nxjerrë mësimet e duhura, a është proceduar rasti siç duhet në rrugë institucionale juridike?

Problemet, më shumë se politike, janë juridike, janë institucionale dhe përshtypja ime është se ka pasur një injorim, ka pasur një indiferencë institucionale, i është lënë kjo çështje familjes dhe përkrahësve, si të thuash, politikë të saj. Dhe, mendoj që koha ka dëshmuar se nuk ka qenë e mirë, ka qenë e mangët.

Madje, as të vrarët, dëshmorët për mendimin tim, nuk janë trajtuar siç duhet, as nuk është rregulluar me ligj, çështja e tyre dhe e familjeve të tyre dhe, për pasojë, nuk është kuptuar as mirë fakti që koha po dëshmon që protesta e organizuar atëherë ka qenë kundër disa rreziqeve që Kosovës do t'i kushtonin shumë. Dhe, kjo vetëm tani në distancën kohore, do të duhej të hiqte çdo dilemë për trajtimin edhe të vetë përpjekjes edhe të atyre që e paguan me jetën e tyre, me rininë e tyre dhe familjeve që e paguan shtrenjtë këtë.

Nëse s'është bërë në të kaluarën, duhet të bëhet sot, duhet të bëhet në të ardhmen dhe angazhimi im është që edhe ky debat të jetë në funksion të konsolidimit të qasjes institucionale, për trajtimin e kësaj padrejtësie të madhe, duke ndjekur procedurat adekuate juridike. Ka në misionet ndërkombëtare edhe instrumente juridike, me të cilat mund të kontestohen padrejtësitë që bëhen dhe unë i përgëzoj ata që kanë punuar, veçanërisht mbrojtësit, e tjerë, por mendoj që ka edhe mundësi që nuk janë shfrytëzuar.

Do të doja të nënvizoj, veçanërisht edhe në aktet e miratuara këto kohët e fundit është krijuar mundësia, që edhe në Evropë të procedohen në mënyrë juridike padrejtësitë që

kanë bërë përfaqësuesit e misioneve paqeruajtëse e paqe bërëse në Kosovë dhe në vendet tjera. Ju falënderoj për vëmendjen!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: E ka fjalën deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, nënkryetar i Parlamentit, zoti Hamiti!
Në fillim, më lejoni t'iu shpreh ngushëllimet e mia familjes Balaj dhe Xheladini.

Të nderuara familje Balaj dhe Xheladini,
Të nderuar deputetë dhe deputete,
Është mirë që ky debat po hapet për zhvillimet tragjike të 10 shkurtit të vitit 2007. Rëndësia e këtij debati nuk qëndron vetëm në pasqyrimin e zhvillimeve të atëhershme, por për t'i dhënë një shtytje, ashtu që më në fund drejtësia të kryejë punën e vet.

Për këtë arsye dhe me këtë rast, Kuvendi i Kosovës ka se çfarë të thotë dhe të debatojë, por pa cenuar në asnjë moment pavarësinë e procesit. Duhet të debatojmë, posaçërisht se më 10 shkurt 2007 humbën jetën dy qytetarë të Kosovës, Arben Xheladini dhe Mon Balaj. Për vdekjen tragjike të tyre, deri më tani askush nuk ka dhënë përgjegjësi. Vdekja e Monit dhe Arbenit, që ndodhi në një protestë të lejuar në secilën shoqëri demokratike, ishte paqësore dhe kishte qëllime dhe kërkesa legjitime.

Sipas raporteve të prezantuara del shumë qartë se përdorimi i armëve të gjata dhe i municionit vdekjeprurës, madje edhe të skaduar, nuk ka qenë i domosdoshëm. Po ashtu, goditja e tyre në pjesët vitale të trupit, në kokë dhe në gjoks, tregon qartë se bëhet fjalë për një ekzekutim. Në këtë rast, njësitë policore duket se nuk kanë pasur për qëllim neutralizimin dhe masivizimin e veprimit të demonstruesve, por eliminimin e tyre.

Të gjitha këto janë arsye të fuqishme dhe të pamohueshme se ky rast nuk bën e as që duhet të heshtet, prandaj me këtë rast Kuvendi i Kosovës duhet të insistojë dhe të ngulë këmbë që drejtësia të përfundojë punën e vet.

Sado që e them, se kjo punë duhet të marrë epilogun përfundimtar, sipas raporteve duket se ajo ende nuk është në fazën fillestare, por megjithatë ekzistojnë dy raporte, të cilët sjellin mjaftë fakte, mjaftë argumente për të gjurmuar edhe më tej në ndjekjen e tyre që shkaktuan vdekjen e dy shtetasve të Kosovës.

Mirëpo, edhe raporti në disa raste anashkalon disa elemente qenësore. Kjo duket aty kur thuhet, se askush nga dëshmitarët e intervistuar nuk kanë qenë në gjendje t'iu identifikojnë individët, që mund të jenë doras.

Po në këtë rast, ky është një fakt jo aq relevant, meqenëse këtu kemi të bëjmë me dhunën shtetërore, në këtë rast UNMIK-un, ndaj qytetarëve të një shteti, të cilëve u është e garantuar e drejta për të protestuar.

Është e qartë se kush i goditi ata për vdekje dhe cilat ishin rrethanat. Predhat vdekjeprurëse erdhën nga njësia policore e UNMIK-ut, në këtë rast nga formacioni rumun, ndërsa kjo ndodhi në momentin, kur ata me asgjë nuk ishin të rrezikuar. Po ashtu, sipas planit operativ, policia ishte urdhëruar që të mos përdorë armët e gjata dhe të jetë e pajisur me sasi të mjaftueshme të gazit lotsjellës. Ndërkaq, njësia policore më këtë rast veproi krejtësisht ndryshe, pos gazit lotsjellës ajo përdori edhe plumba gome, të cilët ishin vdekjeprurës për Monin dhe Arbenin, sikurse që lanë pasojat edhe mbi 80 të tjerë të plagosur.

Pra, pasojat ishin tejet të rënda dhe protestuesit paqësorë, por edhe për tërë popullatën e Kosovës. Ndërkaq askush nuk u mor në përgjegjësi, madje askush nuk pranoi përgjegjësinë, qoftë as si akt moral. Përjashtim bën vetëm ish ministri i Punëve të Brendshme, zoti Famir Rexhepi, i cili ndonëse nuk ishte i ngarkuar me përgjegjësi, ai dha dorëheqje të parevokueshme nga posti që mbante. Ishte ky një akt burrëror i tij, meqenëse në rrethanat ku qytetarët e vendit vriten në një protestë që nuk rrezikonte askënd, çdo ministër i ndërgjegjshëm duhet të ofronte dorëheqje.

Po ashtu, edhe institucioni i Ombudspersonit të Kosovës ka treguar përgjegjësi rreth kësaj ngjarjeje tragjike, pa marrë parasysh pengesat që ka pasur dhe rrethanat, që i kanë pamundësuar punën e pavarur të tij, megjithatë ka konstatuar se policia e UNMIK-ut ka përdorur forcë të tepruar dhe nuk e ka menaxhuar demonstratën në një mënyrë që do të zvogëlonte në maksimum rrezikun për jetën e protestuesve.

Avokati i Popullit gjithashtu vuri në pikëpyetje paanshmërinë e hetimit të UNMIK-ut, ndonëse ka kaluar një kohë e gjatë prej atyre zhvillimeve, saktësisht gjashtë vjet, rasti në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohet i mbyllur, dy veta janë vrarë, shumë të tjerë janë plagosur e ndoshta dikush prej tyre ka edhe pasoja për tërë jetën, ka përplot dyshime në korrektësinë e raporteve.

Dhe, askush nuk ka dhënë llogari për këtë. Kjo nuk është në rregull, kjo është e patolerueshme dhe e papranueshme për cilëndo shoqëri dhe shtet, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për ndërhyrjen e forcave shtetërore për ruajtjen e rendit apo për njësinë me mandat të caktuar, siç kanë qenë ato të UNMIK-ut. Meqenëse, UNMIK-u ishte pushtet real i asaj kohe, atëherë këtu kemi të bëjmë me terrorin, që shteti ka ushtruar ndaj qytetarëve, të cilët është dashur ta gëzojnë mbrojtjen po nga ky pushtet, edhe pse protestuesit nuk kanë rrezikuar jetën e askujt e as pasurinë e kujt do qoftë.

Prandaj, të nderuar deputetë, këtu qëndron edhe arsyeja për debat dhe nevoja që ky në Kuvend të insistojë me këmbëngulje për vazhdimin e procesit dhe për nxjerrjen para organeve të drejtësisë si dorasit e drejtpërdrejtë ashtu edhe ata që kanë përgjegjësi, sipas zinxhirit komandues. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e merr deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!
Të nderuara familje Balaj dhe Xheladini,

I nderuar Zenel Zeneli dhe Hysni Hyseni,
Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në të gjitha vitet e pasluftës thoshin: “Pavarësia në fund të vitit.” Dhe, për çdo fund vit thoshin: “Pavarësia në vitin e ardhshëm.” Nëntë vjet rresht ishte kështu. Me këtë mënyrë u krijua një fiksim me pavarësinë si fjalë për shtetin, pa e konsideruar përmbytjen e saj.

Pra, së pari pavarësia, që kërkohet përjetohet formalisht, duke e ndarë formën nga përmbytja dhe së dyti besohet që forma e përcakton përmbytjen duke e harruar të kundërtën, që edhe përmbytja e përcakton formën.

Dihet që përmbytja e pavarësisë është sovraniteti. Kjo është arsyeja, pse në demonstratën e 28 nëntorit të vitit 2006, patëm thënë që pavarësia e plotë dhe e vërtetë, pra ajo me sovranitet nënkupton katër gjëra, me të cilat matet vetë pavarësia: integriteti territorial, ushtria, Ministria e Punëve të Jashtme dhe ulësja në OKB.

Atëbotë, përveçse u nda forma nga përmbytja dhe u etablua dominimi i së parës, pra i formës, pasoi degradimi i tretë, forma u reduktua në emrin, në emërtimin për shtetin, vetëm le të quhemi të pavarur, thuhej atëherë, kjo është e rëndësishme.

Pakoja e Ahtisarit, siç e mbajmë mend, nuk erdhi as në fund të vitit 2006 dhe u shty aso kohe për shkak të zgjedhjeve në Serbi. Më 2 shkurt të vitit 2007, ateron paketa e Ahtisarit në Prishtinë me gjashtë padrejtësitë themelore, si gjashtë faqet e kubit të paketës. Por, para se ta shpjegoj se cilat ishin këto gjashtë padrejtësi, duhet theksuar se më 2 shkurt të vitit 2007, në paketën e Ahtisarit, askund nuk figuronte fjala “pavarësi”. Rekomandimin për pavarësi të mbikëqyrur Ahtisari ia dërgon veçmas sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, disa javë më vonë, pra edhe pas demonstratës së 10 shkurtit.

Po ashtu, duhet theksuar që në krejt pakon e Ahtisarit, një herë përmendet shqipja, te gjuha shqipe, askund fjala shqiptar, përveç te fjala “komunitetet joshqiptare” dhe 37 herë fjala serbe.

Atëherë, cilat ishin ato gjashtë padrejtësitë themelore të Pakos së Ahtisarit? E para, Pakoja e Ahtisarit flet kryesisht për të drejtat dhe privilegjet e pakicave dhe atë sidomos të pakicës serbe. Kuvendi i Kosovës, me këtë pako, kurthohet nga formula e shumicës së dyfishtë. Kuvendi për çështjet e ligjet jetike ka nevojë për shumicën e përgjithshme dhe shumicën e pakicës, gjë që praktikisht i jep të drejtë vetoje pakicës.

Kjo do të mund të ishte ndoshta e arsyeshme, sikur Kosova ta kishte okupuar Serbinë dhe të kishte bërë agresion mbi Serbinë e jo, siç e dimë, kemi situatën e kundërt, ku Serbia ka bërë agresion dhe ka okupuar Kosovën. Dhe sërish, ndoshta kjo do të kishte kuptim, sikur Kosova t’i kishte 60% shqiptarë e 40% serbë e jo, siç e dimë, realitetin ku shqiptarë janë mbi 90%.

Padrejtësia e dytë, trashëgimi kulturore konsiderohet vetëm ajo fetare ortodokse, e cila është definuar si serbe. Pakoja e parashihte themelimin e 45 zonave të veçanta qindra hektarësh eksterritoriale, që uzurpojnë pronë, kulturë dhe histori.

Padrejtësia e tretë, paketa e Ahtisarit përqendrohet më së shumti te decentralizimi. Komunat e reja me shumicë serbe fitonin kompetenca shumë më të mëdha se sa ato me shumicë shqiptare dhe plotësisht të pazakonshme për komunat, për shembull, në arsimin e lartë, shëndetësinë dytësore, e të tjera. Lidhjet horizontale të tyre hidhnin farën e një entiteti autonom serb, lidhjet vertikale me Beogradin dhe financimin, i cili do të ishte i liruar nga taksat në Kosovë, i hapnin rrugë kontrollit të Serbisë në çerekun e territorit të Kosovës.

Padrejtësia e katërt, instalohej Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, i cili njëkohësisht do të ishte edhe përfaqësues special i Bashkimit Evropian me fjalën përfundimtare për gjithçka, çdoherë. Ky monark i ri do ta kishte fuqinë korrektuese, pra ndryshimin e ligjeve dhe zëvendësuese - përjashtim të ministrave e zyrtarëve të tjerë dhe emërim të dikujt tjetër në ato poste.

Kësisoj, po betonohej protektorati sundues ndërkombëtar mbi Kosovën.

Padrejtësia e pestë, në vend që të flitej për dëmet e luftës që Serbia ia ka shkaktuar Kosovës, Pakoja e Ahtisarit merret me borxhet e Kosovës. Kosova ishte përjashtuar nga suksesioni i ish-Jugosllavisë, nuk ishte zhdëmtuar për plaçkitjet dhe shkatërrimet dhe tash duhej të merrte pjesë në borxhin e jashtëm të Serbisë.

Dhe padrejtësia e gjashtë themelore, dikur në vend që të çarmatosej ushtria kriminale serbo-jugosllave, u çarmatos UÇK-ja. Tash në vend që të shpërbëheshin strukturat policore dhe paramilitare të Serbisë në Kosovë, Pakoja e Ahtisarit parashihte shpërbërjen e TMK-ës.

Dihet që u bë kompromisi i dhembshëm, Serbia fitoi shumë, por mbeti e pakënaqur, pavarësia nuk na kaloi në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Serbia nuk na e njohu pavarësinë dhe përkundër të gjitha këtyre Pakoja e Ahtisarit u zbatua njëanshëm në Kosovë.

Sot Serbia është edhe më tej e pakënaqur dhe në Bruksel po zhvillohen negociata të reja. Serbia e pakënaqur është një Serbi hegjemoniste dhe shoviniste. Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është normalizim i marrëdhënieve me hegjemonët dhe shovinistët jo të penduar për krimet nga e kaluara.

Sikur dje komunat me shumicë serbe, po ashtu edhe sot bashkësia apo asociacioni i këtyre komunave nuk është kërkesë e serbëve të Kosovës, por e Qeverisë së Serbisë. Interesat e Serbisë po kamuflohen me nevojën për integrimin e serbëve.

Ne gjithsesi jemi për integrimin e serbëve, madje jo vetëm në institucione, por edhe në shoqëri, mirëpo integrimi i serbëve në Kosovë nuk mund të kalojë nëpër Beograd, as në veri, e as në jug, as dje as sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Më 15 shkurt, pesë ditë pas demonstratës së 10 shkurtit 2007, Organizata Amnesty International e publikoi deklaratën e saj të parë me të cilën e dënonte vrasjen e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit nga policia e UNMIK-ut dhe plagosjen e mbi 80 protestuesve tjerë.

Krejt ndryshe nga UNMIK-u dhe deklaratat e tjera zyrtare të bëra ato ditë, Amnesty International e përshkroi në mënyrë të qartë demonstratën e 10 shkurtit si "të padhunshme" dhe i bëri thirrje UNMIK-ut që ta ndërmarrë një hetim transparent dhe të paanshëm.

Amnesty International e nxiti UNMIK-un të mos harrojë se në bazë të vetë udhëzimeve të OKB-së, plumbat e gomës nuk duhet të përdoren asnjëherë "përveç në vetëmbrojtje ose për mbrojtje të të tjerëve nga kërcënimi real me vdekje ose me plagosje të rëndë".

Amnesty International gjithashtu shtoi se, "në vetë udhëzimet e UNMIK-ut thuhet se këta plumba nuk duhet të përdoren në distanca të vogla, e as për të qëlluar sipër belit".

Në korrik, Amnesty International e dënoi riatdhesimin e njësitit policor rumun të UNMIK-ut të dyshuar për krime, duke kërkuar që atyre t'u hiqet imuniteti. Që prej shkurtit 2007, në dhjetëra deklarata dërguar UNMIK-ut dhe Qeverisë rumune, Amnesty International ka bërë thirrje të vazhdueshme që Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së t'ua heqë imunitetin policëve të UNMIK-ut dhe zyrtarëve të dyshuar si përgjegjës për vrasjet dhe lëndimet e shkaktuara atë ditë dhe të bëjë një hetim të pavarur, duke mundësuar kështu ndjekje penale të rastit. Këto kërkesa janë bërë pjesë e një fushate botërore të Organizatës Amnesty International, gjatë së cilës mijëra letra ankesash i janë dërguar UNMIK-ut, si dhe letra solidariteti familjeve Balaj dhe Xheladini.

Në vazhdim, po jua lexoj deklaratën e Amnesty International që e ka lëshuar enkas për debatin e sotëm:

Shkurt 2007: "Vonesë e stërzgjatur e drejtësisë për viktimat"

Për më shumë se gjashtë vjet, familjet e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit kanë pritur drejtësi për vdekjen e bijve të tyre. Edhe ata që ishin lënduar rëndë, duke përfshirë Zenel Zenelin, Mustafa Nerjovajn dhe Hysni Hysenin, janë gjithashtu duke pritur drejtësi.

Amnesty International e ka përsëritur vazhdimisht kërkesën që bashkësia ndërkombëtare në Kosovë t'u sigurojë atyre qasje në drejtësi, si dhe dëmshpërblim të plotë për humbjen dhe lëndimet e tyre.

Mon Balaj dhe Arben Xheladini ishin vrarë gjatë një demonstrate të organizuar nga Lëvizja "Vetëvendosje" në Prishtinë, më 10 shkurt 2007. Ata vdiqën kur pjesëtarët e Njësisë së Formuar Policore Rumune, nën komandën e policisë së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, pra UNMIK-ut, qëlluan drejt demonstruesve me plumba gome.

Të tjerët, duke përfshirë Zenel Zenelin, Mustafa Nerjovajn dhe Hysni Hysenin, kishin pësuar lëndime të rënda.

Një hetim i brendshëm i UNMIK-ut, në vitin 2007, konstatoi se shkaku i vdekjes së protestuesve ishte "përdorimi i pavend i plumbave të gomës nga të paktën një ose dy qitës".

Në kohën kur këto përfundime ishin bërë, anëtarët e njësisë policore tashmë ishin riatdhesuar.

Asnjë hetim i pavarur penal në Kosovë nuk është hapur ndonjëherë për vrasjet e kryera dhe lëndimet e të tjerëve. Një hetim i paplotë i një prokurori ushtarak në Rumani ishte mbyllur në dhjetor 2009, pa i identifikuar përgjegjësit.

Amnesty International është në dijeni se familjeve të Mon Balajt dhe Arben Xheladinit, dhe dy të lënduarve, u janë dhënë kompensime për dëmin material nëpërmjet një procesi të brendshëm të OKB-së.

Megjithatë, as të afërmit e të ndjerëve, e as burrat e lënduar, ende nuk kanë marrë ndonjë formë tjetër kompensimi që u takon atyre sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Familjet vazhdojnë të kërkojnë drejtësi që nga viti 2007. Ata kanë ngritur ankesë te Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut, i cili është themeluar në mars 2006 për të siguruar drejtësi ligjore për veprime dhe mosveprime nga UNMIK-u.

Rasti i tyre te Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut është ende në pritje, përkundër kundërshtimeve dhe bllokimeve të vazhdueshme nga UNMIK-u. Por, Paneli Këshillues nuk ka kompetenca për ta nisur një hetim penal, por vetëm sa t'i japë rekomandime UNMIK-ut për ta nisur një hetim të tillë.

Megjithatë, UNMIK-u nuk ka më kompetenca për të bërë hetime dhe ndjekje penale për krime serioze në Kosovë.

Për këtë arsye, Amnesty International kërkon nga Qeveria e Kosovës që ta mbështesë apelin për hapjen e një hetimi të paanshëm dhe të pavarur për vdekjet dhe lëndimet që ndodhën më 10 shkurt 2007.

Duke qenë se edhe hetimi i brendshëm i UNMIK-ut i kishte ngarkuar me fajësi personat në zinxhirin e komandës, veprimet ose mosveprimet e të cilëve kishin shkaktuar përdorimin e plumbave të gomës në një situatë konfuze të rendit publik, hetimi duhet t'i trajtojë të gjitha rrethanat e kësaj ngjarjeje.

Kjo duhet ta përfshijë një hetim për përgjegjësinë e mundshme penale të policisë së UNMIK-ut dhe zyrtarëve të tjerë që ishin në krye të operacionit atë ditë.

Amnesty International u bën thirrje UNMIK-ut dhe shteteve anëtare të OKB-së që të bashkëpunojnë plotësisht me këtë hetim.

Mungesa e vazhdueshme e një hetimi efektiv është shkelje e të drejtave themelore të njeriut, duke përfshirë të drejtën për jetë, ndalimin e torturës dhe trajtimeve të tjera çnjerëzore, të drejtën për tubim paqësor dhe të drejtën për zgjidhje ligjore efektive.

Gjithashtu, Amnesty International ia kujton UNMIK-ut Parimet Themelore të OKB-së dhe Udhëzimet për të Drejtën për Dëmshpërblim dhe Drejtësi Ligjore për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe për Shkeljet e Rënda të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar.

Sipas Amnesty International, UNMIK-u gjithashtu duhet të marrë masa që viktimat dhe të afërmit e të ndjerëve të fitojnë zhdëmtim të plotë në përputhje me të drejtat e tyre sipas ligjit dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Familje të nderuara të Arben Xheladinit dhe Mon Balajt,

Kërkesa për një debat të tillë nënkuptohet, sepse është e pashmangshme që herët a vonë që rastet e humbjes së jetës së njerëzve, apo të themi më qartë të marrjes së jetës në mënyrë barbare dhe të padrejtë dhe kriminale, drejtësia duhet ta thotë fjalën e vet.

Vrasja e Monit dhe Arbenit, si dhe plagosjet fatale që ndodhën atë ditë duhet ta marrin përgjigjen e vërtetë dhe ata që i bënë këto krime ta marrin dënimin e merituar.

Hetimi i përshkruar në raportin e ofruar nuk e tregon të vërtetën e asaj dite. Pse u vranë ata djem dhe pse u plagosën demonstruesit?

Kolegë deputetë,

Një shtet që fle mbi krimin, kurrë nuk mund të bëhet shtet. Vrasjet prapa shpine të luftëtarëve të brigadës “Mërgimi” pas lufte, të oficerëve dhe komandantëve të shquar, vrasjet e kuadrove të larta të LDK-së, vrasjet e gazetarëve kombëtarë, vrasjet e policëve të Kosovës, Sebahate Tolaj e Isuf Haklaj, e deri te tentimvrasja e presidentit Ibrahim Rugova janë njollë e zezë e Kosovës së pasluftës, që kërkojnë drejtësi.

Heshtja e këtyre rasteve e turpëron Kuvendin dhe institucionet e drejtësisë, sepse plagët nuk shërohen duke i mbuluar, por duke e vënë drejtësinë në vend.

Deri dje ishte arsytimi në burokracinë e UNMIK-ut, por a duhet që ky fatalitet yni të jetë i përjetshëm dhe parajsë që i kryen këto krime në këtë arsytim. Prandaj, është e drejtë

dhe legjitime që të gjitha këto familje ta dinë të vërtetën për vrasjet e më të dashurve të tyre dhe ata që i bënë ta marrin dënimin e merituar.

Kolegë deputetë,

A duhet vetëm debati të mbetet ngushëllim? Unë mendoj se jo. A duhet që vetëm ngushëllimi në reagimin njerëzor e familjar të mbetet vetëm e drejtë? Unë mendoj që jo. A duhet që vetëm ndonjë organizatë kredibile, si Amnesty International, të jetë ngushëllim? Unë mendoj se jo.

Prandaj, kolegë deputetë, në Kosovën e pasluftës duhet të sqarohet shumëçka, edhe këto protestat e 10 shkurtit, edhe pranvera e vitit 2004, kur u sulmuan kishat dhe vendbanimet serbe, e si rrjedhojë fatale lindën dhe u konsoliduan enklavat serbe në Kosovë, këto akte të skenuara nga Serbia me argatë shqiptarë, dhe ku mbeti dilema e madhe, kush ishin ata dhe ku janë sot. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëtarë të familjeve Balaj e Xheladini!

E kemi një debat shumë të ndjeshëm dhe konsideroj se duhet pasur kujdes në qasje, në kuptimin që kërkesa jonë duhet të jetë në zbardhjen e drejtësisë, të rastit konkret dhe të shikohen mundësitë legale ligjore në mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë, që drejtësia në Kosovë përfundimisht të vijë në shprehje.

Këtë e them për arsye se përveç një përgjegjësie morale që në një moment ka ndodhur me rastin e dorëheqjes atëherë të ish-ministrit të Punëve të Brendshme, Fatmir Rexhepi, asnjë lëvizje përpara nuk është bërë më që kjo çështje të zgjidhet përfundimisht dhe familjet së paku ta ndiejnë një dorë të drejtësisë në Kosovë, duke e pasur plagën gjithmonë të pranishme, bashkë me ata që e bashkëndiejnë dhembjen.

Në Kosovë sot e kemi një drejtësi që vërtet është paradoks, krahasuar me të gjitha vendet tjera, sepse kemi raste kur për lëndë të cilat janë shqyrtuar më herët, qoftë nga drejtësia vendore, qoftë nga drejtësia ndërkombëtare, kanë hyrë në sirtarë, janë mbyllur, janë shpallur njerëzit të pafajshëm dhe ka ardhur një mision tjetër, përsëri është marrë me të njëjtën temë dhe kemi raste kur nga tri herë, katër herë njerëzit shpallen të pafajshëm, kthehen në gjyqe për ta arsyetuar kryesisht praninë e tyre, e jo më shumë.

Derisa në Kosovë kemi raste të përditshme të sulmeve që ndodhin para institucioneve që kanë për detyrë të dalin në mbrojtje të rendit dhe ligjit, përsëri merren me vepra të kaluara, të cilave absolutisht u ka humbur vlera dhe nuk janë në gjendje ta bëjnë drejtësinë, atëherë kur kjo është e nevojshme për qytetarët e Kosovës.

Në rekomandimet që janë ofruar nga grupi iniciues, duhet që përfundimisht, pasuesi i fundit të jetë obligim, të mos jetë vetëm fjalë për krijimin e një mundësie të një hetimi të pavarur, por Qeveria e Kosovës, institucionet, në këtë rast edhe Parlamenti dhe të gjithë

mekanizmat në Kosovë ta ofrojnë mundësinë që ky hetim i pavarur të mbulohet me njerëzit që e njohin lëndën, e njohin përgjegjësinë juridike, e njohin funksionimin e shtetit, dhe të mos bëhet vetëm debat, i cili mund të mos dalë me efekte, sepse shoqëria jonë ka nevojë për veprime praktike e juridike, të cilat mundësojnë vërtet që drejtësia të funksionojë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar familjarë të dëshmorëve Arben Xheladini e Mon Balaj,

Të nderuar pjesëtarë të plagosur në demonstratën e 10 shkurtit.

Unë do ta trajtoj çështjen e 10 shkurtit pak a shumë në një aspekt se shpeshherë po kuptohet apo po lihet të kuptohet si komplet faji i ngjarjes së 10 shkurtit të reduktohet te një grup i policëve rumunë.

Unë mendoj që ngjarja e 10 shkurtit e ka pasur një mbështjellës politik dhe reagimet e pushtetit në atë kohë nuk janë ndryshe nga reagimet e pushteteve për ngjarjet e ngjashme që ndodhin kudo nëpër botë. Madje, në Kosovë, e cila është përfshirë shumë herë nga demonstratat, një përvojë e tillë është përvojë tejet e njohur.

Vreri politik nëpër deklaratat nga pushteti në ditët menjëherë pas demonstratës i korrespondon plotësisht dhunës së shkaktuar në demonstratë.

Për ta arsyetuar dhunën, akuzat kundër demonstruesve edhe në këtë rast, por edhe në shumë raste tjera, e tejkalojnë edhe logjikën. Dhe, pikërisht kjo është fitorja e parë politike e një demonstrate. Kështu ndodhi shumë herë edhe këtu në Kosovë, por edhe kudo nëpër botë.

Grumbullimi atë ditë enorm i forcave policore, bllokimi i sheshit, pajisja e tyre me makineri dhe veçanërisht armë për të vrarë, kundrejt një mase të paarmatosur që demonstronte përgjatë sheshit, pastaj pajisja me plumba vdekjeprurës, tregon se ata nuk ishin aty thjesht për ta menaxhuar protestën, tregon se ata ishin sjellë aty për të vrarë. Pra, e tërë ngjarja nuk mund të thuhet që ishte rastësi, e cila mund të reduktohet madje edhe në një grup policës.

Dhe, ky fakt në raport me deklaratat e menjëhershme akuzuese të pushtetit doli të jetë tejet i sinkronizuar. Veprimi konkret në terren, i mbështjellë me mbështetjen politike, tregon se së paku po të mos ekzistonte kjo mbështetje politike do të mund eventualisht të thuhej që ndoshta faji ka qenë te një grup i një njësi të vogël, por mbështetja politike e demonstratës dhe dhunës në demonstratë e tregon krejtësisht të kundërtën.

Protesta e prishte të ashtuquajturin unitet për Pakon e Ahtisarit. Kundërshtimi politik i negociatave dhe i Pakos së Ahtisarit ishte bërë i padurueshëm. Kjo rezultoi me dhunën dhe arrestimin e Albin Kurtit nga policia e UNMIK-ut menjëherë atë mbrëmje, si dhe me

mbylljen e të gjitha zyrave të Lëvizjes “Vetëvendosje” kudo që ndodheshin ato nëpër Kosovë, si dhe sekuestrimi i materialeve nëpër zyra.

Demonizimi dhe shpallja si organizatë ekstremiste përbënin synim. Kjo gjë do ta shndërronte këtë Lëvizje më lehtë në shënjestër. U pa si shans atëherë për eliminimin e çfarëdo faktori që asokohe e kundërshtonte procesin politik, duke përfshirë edhe Lëvizjen “Vetëvendosje”.

Atyre ditëve të para pas demonstratës nëpër deklarata mbretëronte fajësimi. UNMIK-u, në njërën anë, Grupi i Unitetit, në anën tjetër, dhe këtij grupi u ishin bashkuar edhe deklaratimet nga ambasadat. Ishte bërë një Grup i madh i Unitetit, me një pikë të vetme bashkimi, mbrojtjen e pakos dhe fajësimin e demonstruesve.

Kudo nëpër deklarata fajësohej Lëvizja “Vetëvendosje”, fajësoheshin ata që e kishin thirrur protestën e dhunshme, siç e quanin ata, ku thirrja e protestës dhe protesta e “dhunshme”, pra siç e quanin, synohej të bëhej fajtori i vrasjes së dy demonstruesve dhe i plagosjes së 80 të tjerëve.

Asokohe, Grupi i Unitetit e dënoi me deklaratën: “Protesta e dhunshme e nxitur nga Albin Kurti dhe Lëvizja “Vetëvendosje”, me ç’rast dy persona e humbën jetën e tyre dhe qindra të tjerë u lënduan, shkaktoi tension të veçantë, duke e dëmtuar stabilitetin e Kosovës dhe interesin e përgjithshëm.”

Arsyetimi i UNMIK-ut, i disa ambasadave dhe i Grupit të Unitetit ishte me frazën se demonstruesit kishin dashur të hynin në ndërtesat e Qeverisë dhe të shkatërronin, të digjinin makina, edhe pse ndalimi i protestës kishte ndodhur në shesh, e jo te hyrjet e ndërtesave.

Kështu deklaroi UNMIK-u, KFOR-i e ambasadorët etj. Injorohej fakti që protestuesit ishin shpërndarë nga lotsjellësi dhe ishin gjuajtur me plumba gome tek pas tërheqjes së tyre shumë më larg nga kordoni i policisë.

Pra, vrasjet dhe plagosjet nuk u shkaktuan në përpjekje sulmi apo dhune, siç thuhej, por në tërheqje e sipër.

I vetmi veprim i moralshëm gjatë atyre ditëve ishte dorëheqja e ministrit të brendshëm Fatmir Rexhepi, personit që më së paku kishte të bënte me dhunën në atë protestë.

Dhuna ishte shkaktuar nga policia e UNMIK-ut, ishte mbrojtur nga faktori politik ndërkombëtar dhe vendor, e policët e SHPK-së në protestë ato ditë ishin më së paku pjesë e kësaj dhune, edhe pse zëdhënësi asokohe i Policisë, Veton Elshani, u bë pjesë shpeshherë e lojës politike, duke e mohuar përdorimin e plumbave.

Ajo që është e vlefshme të përmendet, është fakti që pushteti politik, pra UNMIK-u e përdori për dhunë policinë e vet. Policët e Kosovës nuk do të mund të bënin gjë të tillë në

atë kohë. Strukturat e policisë nuk ishin të politizuara dhe rrjedhimisht nuk mund t'i përdorte si mjet në dorën e tyre kundrejt qytetarëve.

Nëse bëjmë një ndarje të qartë ndërmjet Grupit të Unitetit dhe strukturave të atëhershme, pushtetit të atëhershëm, bëjmë ndarje të qartë nëpërmjet Qeverisë, subjekteve politike dhe përgjegjësisë politike në këtë rast, është jo Qeveria, por është një Grup i Unitetit që ka ekzistuar atëherë, i cili e akuzonte, krahas politikës së UNMIK-ut, këtë protestë.

Me kalimin e ditëve, e vërteta filloi të zbardhej. Kjo e vërtetë e bëri dhe shefin e policisë së UNMIK-ut, Stiven Kurtis, të jepte dorëheqje. Më vonë doli dhe raporti i hetimit nga Robert Din, raport ky që i shfaqësoi demonstruesit dhe dhunën e quajti si të shmangshme dhe të panevojshme, edhe pse nuk e gjente fajtorin ndërmjet policëve, si dhe në zinxhirin komandues.

Policia rumune u tërhoq nga Kosova për t'u dekoruar në vendin e tyre.

Në këtë situatë duhet përmendur reagimin e drejtë të Avokatit të Popullit, si dhe organizatës ndërkombëtare Amnesty International në lidhje me demonstratën.

Duhet përmendur qindra e qindra letra të qytetarëve nga e gjithë bota, nga tërë kontinentet e botës si përkrahje për familjarët dhe në favor të arritjes së drejtësisë. Çdo ditë që kalonte kuptohej Pakoja e Ahtisarit, kuptohej edhe e vërteta e 10 shkurtit. Kjo ishte shqetësuese për procesin, prandaj ishte i domosdoshëm një proces gjyqësor, ku do të dënohej Lëvizja "Vetëvendosje" nëpërmjet Albin Kurtit.

Faktori ndërkombëtar ishte i angazhuar për këtë. Ata donin me çdo kusht ta mbronin UNMIK-un nga kushdo, edhe nga faktori politik vendor.

Publikimi i kabllogrameve më vonë nga WikiLeaks shfaq diçka të pashembullt. Ambasadorja e Kosovës, Tina Kaidanov, sipas WikiLeaks-it kishte: "Do të parandaloj çdo përpjekje nga udhëheqësit e Kosovës për t'ia ngarkuar fajin UNMIK-ut apo komunitetit ndërkombëtar për vdekjen e hidhur të dy protestuesve - veçanërisht nëse hetimi tregon se njësitë e formuara policore që bëjnë kontroll të turmave e trazirave kanë kryer të shtënat fatale". Do të thotë, edhe përkundër të vërtetës, ata nuk donin të fajësohej UNMIK-u. Dhe, në këtë pikë, ata e kishin mjaft të ndarë mendjen. Ata ishin në gjendje të ishin edhe kundër udhëheqësve politikë vendorë, pavarësisht qëndrimit të tyre, vetëm e vetëm që ta mbronin UNMIK-un në këtë rast.

Faktori politik i Kosovës nuk u tërhoq asnjëherë nga deklaratat e bëra, edhe përkundër raportit të hetimit, edhe përkundër pranimin të fajit nga UNMIK-u, edhe përkundër faktit dhe vendimit të OKB-së për pranim të fajit dhe për t'i dëmshpërblyer familjarët e të vvarëve. Kjo tregon se ata tash ose po i qëndrojnë ende besnik Tina Kaidanovit, ose po u duhet edhe sot 10 shkurti si kërcënim.

UNMIK-u që u tërhoq nga veprimi nuk është tani në pushtet, por ata që janë tani në pushtet nuk po tërhiqen plotësisht nga veprimi më 10 shkurt kundrejt qytetarëve.

Asokohe u përdor policia për ta mbrojtur një projekt të dëmshëm, si Pakoja e Ahtisaarit. U përdor kundrejt qytetarëve.

Mostërheqja nga qëndrimet në të shkuarën lejon të kuptojë që edhe sot mund të ketë gatishmëri që policia të shndërrohet në instrument për mbrojtje të pushtetit nga qytetarët.

Është shqetësuese, madje edhe në Kuvend, kryeministri sërish e fajëson Lëvizjen “Vetëvendosje”. Kjo lë përshtypjen që këtu ka nevojë për t’u përdorur 10 shkurti ende si kërcënim. Ka nevojë të përdoret ndoshta policia si instrument në duart e pushtetit, e që shpeshherë kemi pasur rast ta shohim konkretisht.

Prandaj, dënimi i dhunës së 10 shkurtit është i domosdoshëm për sigurinë e qytetarëve, për garantimin e një shoqërie demokratike, ku policia është në shërbim të qytetarëve. Mosdënimi e sjell të kundërtën.

Çka tjetër do të duhej të bënin institucionet e Kosovës? Janë pikërisht këto kërkesa që u thanë, që kanë të bëjnë me kërkesën nga Republika e Shqipërisë që ta nisë çështjen e hetimit dhe të realizohet hetimi nga OKB-ja, sidomos tash për faktin që OKB-ja në njëfarë mënyre e ka pranuar fajin si dhe e ka marrë një vendim që kudo nëpër botë të mos përdoren plumbat e gomës. Kjo është një derë e hapur që ne do të mund ta shfrytëzojmë kundrejt edhe pushtetit të UNMIK-ut, edhe kundrejt dhunës që ka ndodhur më 10 shkurt.

Kjo luftë për drejtësi tani ka nevojë për përkrahjen e shtetit.

Edhe një gjë tjetër do të doja ta them. Arben Xheladini dhe Mon Balaj atë ditë kishin dalë në protestë për të drejtën e vetëvendosjes, jo domosdoshmërisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia vazhdo fjalën...!

LIBURN ALIU: ...pra, e drejta dhe kërkesa për vetëvendosje, qytetarët shqiptarë përgjatë dekadave shumë herë i ka nxjerrë nëpër rrugë në protesta. Edhe më 10 shkurt protestuesit dolën për këtë të drejtë.

Prandaj, ata janë dëshmorë të kësaj të drejte, që i bie se janë dëshmorë të kombit. Nuk janë dëshmorë të një organizate. Organizatat mund të shkojnë e të vijnë. Ata janë dëshmorë të kombit, e jo të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit kryetar!

I nderuari nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Shumë të respektuar familjarë që jeni sot këtu me ne.

Qeveria nuk është këtu, ndonëse ky debat ndoshta nuk ka të bëjë me anëtarët që janë sot, e që nuk kanë qenë atëherë, por Qeveria do të duhej të ishte këtu, sepse detyrat që të dalin, rekomandimet që do të dalin prej kësaj seance janë pikërisht rekomandimet të cilat kërkohen prej Qeverisë që t'i zbatojë, prandaj mungesa e tyre është totalisht e paarsyeshme sot në këtë Kuvend gjatë këtij debati.

Para 6 vjetësh, më 2006, ka qenë me të vërtetë tronditës fakti që 7 vjet pas luftës në Kosovën e çliruar të ketë vrasje të qytetarëve të Kosovës dhe atë prej një misioni paqeruajtës, prej një misioni i cili do të duhej që të sillte paqe në Kosovë, e jo t'i vriste qytetarët e saj.

Pas kësaj dhe shumë peripecive e ndodhive, të cilat kolegët e mi deputetë i cekën, ishte edhe hetimi i cili i dha të drejtë dhe nuk dua të koncentrohem në fjalët, të cilat veç u thanë, por vetëm desha të them se në qoftë se në atë kohë, në kohën para pavarësisë së Kosovës, në kohën kur institucionet e Kosovës ishin institucione të përkohshme, kur ministri Fatmir Rexhepi, i një ministrie shumë të re atëherë, nuk pati mundësi që të ndikojë, nuk pati mundësi dhe fuqi që ta shtyjë më tepër këtë çështje dhe e vetmja mundësi të cilën ai e pati ishte akti moral, akti i dorëheqjes, akti i dorëheqjes me të cilën jo vetëm që e tregon se nuk ka mundësi të ndihmojë në këtë rast, por edhe ta shprehë revoltën ndaj mungesës së vullnetit të institucioneve ndërkombëtare që këtë rast ta shtyjnë.

Mirëpo, sot Kosova është shtet i pavarur dhe mundësitë e institucioneve tona, të kësaj Qeverie, e cila sot po mungon këtu në karriget e Kuvendit, janë ndryshe, dhe fuqia e institucioneve të cilat më nuk janë institucione të përkohshme, është një fuqi tjetër.

Dhe vrasja është krim i cili nuk vjetrohët, dhe edhe pse kanë kaluar 6 vjet kjo duhet të riinicohet dhe të kërkohet dënimi i fajtorëve. Dhe, ajo çka familjet e Arben Xheladinit, të Mon Balajt dhe të tjerët nuk janë nevojë apo fjalë për ngushëllime të tyre, por atyre u duhet dënimi i fajtorëve. Ndërsa shtetit të Kosovës i nevojitet që ta çojë drejtësinë në vend, që të tregojë që me të vërtetë është shtet dhe me të vërtetë kujdeset për qytetarët e saj.

Prandaj, ne u kemi borxh familjarëve, por edhe qytetarëve të Kosovës dhe të shteteve tjera, ku janë dhe ku do të shkojnë këto misione paqeruajtëse nesër. Prandaj, mendoj se institucionet tona dhe Kuvendi sot duhet të rekomandojë veprimet për Qeverinë dhe Qeveria do të duhej që të jetë e pranishme dhe fuqishëm t'i mbrojtë dhe t'i realizojë këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara familje Balaj dhe Xheladini,

Të nderuar deputetë,

Desha të shtoj në lidhje me parafolësen, që mos të harrojmë se mungesa e pranisë së ministrave sot është më shumë se e papërgjegjshme, të mos harrojmë se ish-kryeministri i

atëherëshëm i Kosovës, kur kanë ndodhur ngjarjet e 10 shkurtit është ministër aktual dhe do të ishte etike dhe e moralshme që sot së paku të ishte në këtë debat, pra të merrte pjesë. Së paku të dëgjonte, se besoj që edhe ai e ka pasur një lloj përgjegjësie.

Çështja për të cilën dua të flas unë lidhet pikërisht me një këndvështrim tjetër. Kontingjenti rumun i policisë së UNMIK-ut i përket një shteti që është pjesë e Bashkimit Evropian. Nuk është fjala për ndonjë shtet që mund të vijë nga Afrika apo nga Azia, me demokraci të pakonsoliduar, e ku shkelen të drejtat e njeriut, ku nuk respektohet rendi dhe ligji.

Ky shtet, si pjesë e Bashkimit Evropian, jo vetëm që nuk ndërmori ndonjë proces gjyqësor ndaj policëve të cilët kryen vrasje në Kosovë, policë të cilët derdhën plumba si të marrë ndaj protestuesve, kam qenë vetë e pranishme dhe i kam parë, por përkundrazi i ka dekoruar ata, i ka shpërblyer për vrasje. Nuk e di se mund të ketë një veprim më të pamoralshëm se kaq.

Unë e shtroj pyetjen: Nëse Rumania i mban të njëjtat vlera me ato të Bashkimit Evropian? Së paku në rastin konkret, nuk na e ka dëshmuar këtë. Mohimi i të drejtës për jetë është shkelja më e rëndë e të drejtave të njeriut. Atëherë si mund një vend demokratik, pjesë e familjes së madhe demokratike, që është Bashkimi Evropian, të sillet në një mënyrë të tillë. Kjo është një pyetje që besoj kërkon përgjigje, jo vetëm nga shteti i Rumanisë, por edhe nga vetë Bashkimi Evropian.

Si për të mos mjaftuar kjo, Rumania është vendi i parë që ka vrapuar t'i dërgojë kontingjentet e veta të policëve edhe në misionin e EULEX-it. Mos të harrojmë, i kemi të njëjtit policë, ndoshta jo të njëjtit emra, me të njëjtat kompetenca dhe me të njëjtin imunitet, që mund të sillen në mënyrë të njëjtë.

KRYETARI: Deputete, të lutem, këtu ka qenë administrata ndërkombëtare, nuk ka qenë asnjë vend tjetër dhe adresoj fluamurit në të cilin është administruar Kosova në atë kohë. Mos u merr me vende të veçanta. Unë duhet të them se ne jemi të obliguar saktësisht t'i adresojmë çështjet.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Por, mendoj se e njoh shumë mirë këtë çështje, sepse vendet e OKB-së i dërgojnë kontingjentet sipas shteteve në OKB, prandaj po i them këto.

Pra, e gjitha kjo duket shumë e pamoralshme nga Rumania, e cila është një shtet që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Është e pamoralshme edhe nga ana e BE-së që dërgon në Kosovë kontingjente të policisë nga shtetet, të cilat nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Për mua personalisht, mënyra se si është shtypur demonstrata e 10 shkurtit ishte një dëshmi se koncesionet ndaj Serbisë do të implementoheshin edhe me gjak.

Kosova është dëshmi e gjallë se imponimi me dhunë e me gjak nuk do të mund të sjellë kurrë stabilitet. Këtë do të duhej ta kishin mësuar ata që merren me zgjidhjen e konfliktit

ndërmjet Kosovës e Serbisë. Këtë duhet ta dinë edhe ata që shkojnë e bisedojnë me Serbinë, pa mbështetjen e popullit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti dhe nënkryetari Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të ju them të drejtën, nuk e ndjeva veten mirë që kjo seancë është shndërruar në një tip komemoracioni, sepse unë nuk mendoj që e ka pasur këtë qëllim, pa marrë parasysh që kam simpati, që i bie shqip - bashkëdhimbje për ata që kanë humbur njerëz dhe një komemoracion e asnjë përvjetor për ta nuk do të thotë shumë, sepse dhembja është e përjetshme.

Çështja është shtruar për një demonstratë e për një kauzë, po them, se “Vetëvendosje”, pos liderit të vet, as që e shtrou këtë problem qartë. Ata njerëz nuk janë viktima, se tjetër është viktima kot, nëse ata kanë rënë për një kauzë ose janë heronj, ose janë viktima anësore, siç thonë, prandaj duhet që të jetë e qartë kjo, edhe për ata njerëz, edhe për familjarët, por edhe për ne që po ua kushtojmë një seancë.

Domethënë, kemi të bëjmë me një situatë, kur njerëzit dalin dhe e bëjnë luftën e vet në mënyrën e vet politike për një kauzë. Kauza gjithmonë ka kundërshtarë të fortë, se përndryshe s’është kauzë. Dhe në këtë ndeshje është prodhuar vrasja e dy njerëzve dhe një mori plagosjesh. Unë nuk dua të flas për numra, sepse evidencat ekzistojnë. Plus, është një ngjarje e dokumentuar, jo vetëm me një akt juridik rreth drejtësisë, i cili po citohet, po është e dokumentuar me pamje, me evidenca, me emra, me mbiemra, me ndodhitë.

E tash, ne jemi në Kuvendin e Kosovës dhe po e shtrojmë pra një problem. E çfarë dua të them? Unë dua të them se problemin që po shtrohet, unë e shoh përtej asaj dite dhe përtej asaj ngjarje, se a duhet për kauzën politike të vritet njeriu për t’u kuptuar kauza apo jo, sepse jemi në Kuvendin e Republikës së Kosovës tash. Nuk jemi në kuvendin e udhëheqjes, që quhej e përkohshme, e tjera.

Pra, çështja është shumë më e thellë sesa rishikimi i një ngjarjeje, e cila është e dhimbshme, sepse përndryshe nuk merret mësim. Edhe në pësim nuk merret mësim, as politik, as konstitucional, as institucional. Prandaj, shtrohet pyetja e sovranitetit. Çka është sovraniteti, se në tërë rastet, edhe atëherë, edhe sot, nëse s’e ke sovranitetin, e ke varshmërinë dhe ata që vijnë nesër mund të na thonë ne - këta e kishin mbi krye dikë, por s’u sollën mirë.

Unë e dëgjova sot qysh u interpretua kjo punë. Iu bë një nderim ministrit të Brendshëm, i cili si akt moral ka dhënë dorëheqje për ndodhitë, por ne e pamë njëfarë kualifikimi, që s’është real, se unë ato kohëra i kam përjetuar këtu, në Kuvend, dhe u tha që Policia e Kosovës ose SHPK-ja ka qenë një tufë e engjëjve, që bile ta kishin lënë do të bënte edhe luftë.

Mosni ashtu, se s'është e vërtetë kjo. Nuk është në rregull kjo. Sepse, atëherë i bie që edhe sot, nëse kemi një përsëritje që një kauzë të ndalet me gjak, tash në një të ardhme do të thuhet jo se do ta bënin - zemra u rrihte, por s'i lanë.

Ne jemi në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ne po e shqyrtojmë një çështje që do drejtësi... Dhe unë i lexova kërkesat, kërkesat të dyja janë të ndërmjetme, Republika e Kosovës duhet të kërkojë nga Republika e Shqipërisë, e cila do të kërkojë nga Asambleja, do të thotë nëpër tri shkallë, dhe e dyta Republika e Kosovës prapë i drejtohet Këshillit të Sigurimit, e tjera.

Çfarë po dua të them për kërkesat?

Nën një, organizimi ynë nuk po e dëfton këtë, sepse s'e kemi ministrin e Drejtësisë, i cili e merr përgjegjësinë edhe në bazë të kërkesave t'i çojë punët tutje. E qysh e jep njeriu përgjegjësinë që s'është këtu. Qysh?

E dyta, që është edhe më e madhe për mua, për rastet ekzistuese, e këto në Kosovë unë që i mbaj mend, prej '68-shit, janë pak a shumë të ngjashme, pra për të kërkuar ndihmë, për të kërkuar prej dikujt që të jetë i paanshëm në drejtësi, duhet të japësh prova që je i paanshëm në drejtësi.

Zonja e zotërinj,

A jep Kosova prova të paanshme që është e zonja ta çojë drejtësinë deri në fund për çështjet që i ndodhin këtu? Për të kërkuar, duhet të jesh i bindshëm, përndryshe fjalët tona kthehen prapë në komemoracion dhe mua nuk më pëlqen komemoracioni.

E thashë, kam simpati, dhimbje pa fund, por kjo nuk e zgjidh problemin. Ne duhet t'i shohim këto probleme dhe nuk duhet të flasim me figura, se unë figurat i kuptoj, se edhe e kam zanat atë punë, fundi i fundit, por të krijohen lavde për një ministër që është i partisë së LDK-së dhe po të isha ndonjë farë, si po i thonë militant i kalltë i partisë, unë isha kënaqur, por nuk është problemi aty, sepse ai që e ka një fije përgjegjësie institucionale. Ky që e kemi ministër tash, thotë as veshi s'më shkon të japë dorëheqje, bile veç nëse më heq dikush. Domethënë ne këta jemi, ju lutem, të mos e luajmë lojën që s'e dimë ku jemi.

Pra, duhet besueshmëria e brendshme për sende të mëdha, të jemi të zotë për sende të mëdha të bëjmë konsensus politik, e të mos mbajmë variacione të sjelljes që na bëjnë të flijuar ose të humbur, cilado anë qoftë.

Unë për këtë dola këtu. Unë ndjeva nevojë njerëzore, ndjeva nevojë politike, konstitucionale, t'i them këto tri-katër fjalë këtu. Nuk munda të mos i them, sepse ne jemi, zonja e zotërinj, në situata të ngjashme, të pozicionimeve nacionale që s'ka të bëjë me një njeri, me një grupacion, me një sedër, me një mënyrë të sjelljes e të folurit, që zoti nuk ua ka dhënë të gjithëve njësoj as si dije, as si mënyrë të shprehjes. Pra, që mund të gjejë mënyra të mos krijojmë viktima pa rezultate. Faleminderit!

KRYETARI: Kush e do fjalën përfundimtare? Fjala përmbyllëse është e kërkuesit të debatit, e kryetari i Grupit, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit kryetar!

Unë natyrisht se nuk kam çka t'i shtoj këtij debati, përveç se desha t'i lexojë edhe një herë rekomandimet, më shumë për opinionin publik se sa për ju, meqenëse ju tashmë i keni marrë dhe i keni lexuar ato dhe të tregoj se është një ndryshim shumë i vogël në rekomandimin në pikën 2. Kur të vij aty, do të ju tregoj cili është ndryshimi.

Pra, rekomandimet të cilat i hedhim sot në votim në Kuvend janë këto:

1.) Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë që ta iniciojë një debat dhe rezolutë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, duke kërkuar:

a) Që Këshilli i Sigurimit i OKB-së ta fillojë një hetim të veçantë dhe të pavarur të krimeve të kryera nga policia e UNMIK-ut më 10 shkurt 2007 në Kosovë;

b) Që Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së t'ua heqë imunitetin zyrtarëve civilë dhe policorë të UNMIK-ut në zinxhirin komandues, si dhe njësisë së policisë speciale të dyshuar për kryerje krimesh kundër protestuesve paqësorë më 10 shkurt 2007;

2.) Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të kërkojë nga ministrat e jashtëm të vendeve me përfaqësim të përhershëm në Këshillin e Sigurimit, të vendeve që e kanë njohur Kosovën, si dhe mbështetësve të tjerë që janë anëtarë të përkohshëm, të propozojnë që:

a) Këshilli i Sigurimit ta autorizojë një hetim të veçantë dhe të pavarur të krimeve të kryera nën autoritetin e UNMIK-ut më 10 shkurt 2007, dhe

b) Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së t'ua heqë imunitetin zyrtarëve civilë dhe policorë të UNMIK-ut në zinxhirin komandues, si dhe njësisë speciale të policisë të dyshuar për krime kundër protestuesve paqësorë më 10 shkurt 2007.

3.) Ministrat dhe të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet të angazhohen për ngritjen e kërkesës për një hetim të pavarur në takimet e tyre me zyrtarë relevantë të Bashkimit Evropian dhe të Organizatës së Kombeve të Bashkuar, si dhe me diplomatë të tjerë ndërkombëtarë.

Pra, ju ftoj të gjithëve që t'i votoni këto tri rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarët e grupeve, jeni dakord me rekomandimet e lexuara?

Të pranishëm janë 66 deputetë. Atëherë lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 65 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i miratoi rekomandimet për demonstratën e 10 shkurtit 2007, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Me këtë e përfundojmë seancën.

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë